Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 18
Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare

Objektivi

1 Ky Standard përshkruan kërkesat për paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në *pasqyrat financiare për qëllim të përgjithshëm* (pasqyra financiare) për të siguruar që ato japin informacione të rëndësishme që pasqyrojnë në mënyrë besnike aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat dhe shpenzimet e një njësie ekonomike.

Qëllimi

2 **Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Standard në paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me *Standardet e Kontabilitetit SNRF*.**

3 Ky Standard përshkruan kërkesat e përgjithshme dhe specifike për paraqitjen e informacionit në pasqyrën(at) e performancës financiare, pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto. Gjithashtu, ky Standard përshkruan edhe kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në *shënimet shpjeguese*. SNK 7 *Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare* përshkruan kërkesat për paraqitjen dhe dhënie informacionesh shpjeguese mbi fluksin e mjeteve monetare. Megjithatë, kërkesat e përgjithshme për pasqyrat financiare në paragrafët 9–43 dhe 113–114 zbatohen edhe për pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare.

4 Standardet e Kontabilitetit, SNRF-të e tjera përshkruajnë kërkesat e njohjes, matjes, paraqitjes dhe dhënies së informacioneve shpjeguese për transaksione specifike dhe ngjarje të tjera.

5 Ky Standard nuk zbatohet për paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare te ndërmjetme të përgatitura në zbatim të SNK 34 *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*. Megjithatë, paragrafët 41–45 dhe 117–125 zbatohen edhe për këto pasqyra financiare.

6 Ky Standard përdor një terminologji që është e përshtatshme për njësitë ekonomike fitimprurëse, përfshirë njësitë e biznesit të sektorit publik. Nëse njësitë ekonomike me aktivitet jofitimprurës në sektorin privat ose publik zbatojnë këtë Standard, ato mund të kenë nevojë të ndryshojnë përshkrimet e përdorura për nënzëra të veçantë, kategori, nëntotale apo totale të pasqyrave financiare dhe për pasqyrat financiare në vetvete.

7 Në mënyrë të ngjashme, njësitë ekonomike që nuk kanë kapitalin neto siç përcaktohet në SNK 32 *Instrumentet financiarë: Paraqitja* (p.sh. disa fonde të përbashkëta) dhe njësitë ekonomike, kapitali aksionar i të cilave nuk është kapitali neto (p.sh. njësitë ekonomike kooperativa) mund të kenë nevojë të përshtasin paraqitjen në pasqyrat financiare të interesave të anëtarëve ose të mbajtësve të pjesëve.

8 Shumë njësi ekonomike paraqesin një raport rishikimi financiar të drejtimit, veçmas nga pasqyrat financiare (shih paragrafin 10), që përshkruan dhe shpjegon tiparet kryesore të performancës dhe pozicionit financiar, si dhe pasiguritë kryesore të ndeshura. Një raport i tillë është jashtë objektit të Standardeve të Kontabilitetit SNRF.

Kërkesat e përgjithshme për pasqyrat financiare

Objektivi i pasqyrave financiare

9 Objektivi i pasqyrave financiare është që të japin informacion financiar rreth aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë ekonomike raportuese që është i dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare kur vlerësojnë mundësinë e hyrjeve neto të ardhshme të mjeteve monetare tek njësia ekonomike dhe kur vlerësojnë përgjegjshmërinë e drejtimit ndaj burimeve ekonomike të njësisë.

Paketa e plotë e pasqyrave financiare

10 **Një paketë e plotë e pasqyrave financiare përmban:**

(a) pasqyrën (ose pasqyrat) e performancës financiare për periudhën e raportimit (shih paragrafin 12);

(b) një pasqyrë të pozicionit financiar në fund të periudhës së raportimit;

(c) një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën e raportimit;

(d) një pasqyrë të flukseve të mjeteve monetare për periudhën e raportimit;

(e) shënimet për periudhën e raportimit;

(f) informacion krahasues mbi periudhën e mëparshme siç specifikohet në paragrafët 31–32; dhe

(g) pasqyrën e pozicionit financiar në fillim të periudhës paraardhëse siç kërkohet nga paragrafi 37.

11 Pasqyrat e renditura në paragrafët 10(a)–10(d) (dhe informacioni krahasues përkatës) janë *pasqyrat financiare kryesore*. Një njësi ekonomike mund të përdorë emërtime/tituj të tjerë për pasqyrat, të ndryshëm nga ata të përdorur në këtë Standard. Për shembull, njësia ekonomike mund të përdorë emërtimin 'pasqyra e bilancit' në vend të 'pasqyra e pozicionit financiar'. Gjithashtu, edhe pse ky Standard përdor terma si '*të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse*', '*fitimi ose humbja*' dhe '*totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse*', njësia ekonomike mund të përdorë terma të tjerë për të emërtuar totalet, nën-totalet dhe nënzërat e kërkuar nga ky Standard për sa kohë që emërtimet reflektojnë në mënyrë besnike karakteristikat e zërave, siç kërkohet nga paragrafi 43. Për shembull, një njësi mund të përdorë termin 'të ardhura neto' për të emërtuar termin 'fitimi ose humbja'.

12 Njësia ekonomike do të paraqesë pasqyrën(at) e saj të performancës financiare si:

(a) një pasqyrë të vetme të rezultatit (fitimit ose humbjes) dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me fitimin ose humbjen dhe të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse të paraqitura në dy pjesë—nëse zgjidhet ky opsion, njësia ekonomike do të paraqesë në pjesën e parë fitimin ose humbjen që do të ndiqet menjëherë nga pjesa e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; ose

(b) një pasqyrë të fitimit ose humbjes dhe një pasqyrë të veçantë që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse, e cila do të fillojë me fitimin ose humbjen—nëse është zgjedhur ky opsion, pasqyra e fitimit ose humbjes do të paraprijë pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse.

13 Në këtë Standard:

(a) pjesa e fitimit ose humbjes e përshkruar në paragrafin 12(a) dhe pasqyra e fitimit ose humbjes e përshkruar në paragrafin 12(b) referohet si pasqyra e fitimit ose humbjes; dhe

(b) pjesa e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse e përshkruar në paragrafin 12(a) dhe pasqyra që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse e përshkruar në paragrafin 12(b) referohen si pasqyra e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

14 Njësia ekonomike do të paraqesë secilën prej pasqyrave financiare kryesore me rëndësi të barabartë në paketën e plotë të pasqyrave financiare.

Roli i pasqyrave financiare kryesore dhe i shënimeve shpjeguese

15 **Për të realizuar objektivin e pasqyrave financiare (shih paragrafin 9), një njësi ekonomike paraqet informacionin në pasqyrat financiare kryesore dhe jep informacion shpjegues në shënimet. Njësia ekonomike duhet të paraqesë ose të japë si informacion shpjegues vetëm *informacion material* (shih paragrafët 19 dhe B1–B5).**

16 **Roli i pasqyrave financiare kryesore është që të japin përmbledhje të strukturuar të aktiveve, të detyrimeve, të kapitalit neto, të të ardhurave, të shpenzimeve dhe të flukseve monetare të njohura për një njësi ekonomike raportuese, që janë të dobishme për përdoruesit e pasqyrave financiare për të:**

(a) patur një pamje të kuptueshme të aktiveve, të detyrimeve, të kapitalit neto, të të ardhurave, të shpenzimeve dhe të flukseve monetare të njohura për një njësi ekonomike;

(b) të bërë krahasime mes njësive ekonomike dhe mes periudhave raportuese për të njëjtën njësi ekonomike; dhe

(c) identifikuar zërat ose fushat rreth të cilave përdoruesit e pasqyrave financiare mund të dëshirojnë të kërkojnë informacion shtesë në shënimet shpjeguese.

17 **Roli i shënimeve shpjeguese është që të japin informacionin material të nevojshëm:**

(a) për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë nënzërat e paraqitur në pasqyrat financiare kryesore (shih paragrafin B6); dhe

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) për të plotësuar pasqyrat financiare kryesore me informacion shtesë për të realizuar objektivin e pasqyrave financiare (shih paragrafin B7).

18 Njësia ekonomike do të përdorë rolet e pasqyrave financiare kryesore dhe të shënimeve shpjeguese, të përshkruara në paragrafët 16–17, për të përcaktuar nëse do të përfshijë informacionin në pasqyrat financiare kryesore apo në shënimet shpjeguese. Rolet e ndryshme të pasqyrave financiare kryesore dhe të shënimeve shpjeguese nënkuptojnë që niveli i informacionit të kërkuar në shënimet shpjeguese ndryshon nga ai i kërkuar në pasqyrat financiare kryesore. Ndryshimet nënkuptojnë që:

(a) për të dhënë përmbledhjen e strukturuar të përshkruar në paragrafin 16, informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare kryesore është më i grupuar sesa informacioni i paraqitur në shënimet shpjeguese; dhe

(b) për të dhënë informacionin e përshkruar në paragrafin 17, informacion më i detajuar mbi aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike, duke përfshirë *ndarjen* e informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare kryesore, jepet në shënimet shpjeguese.

Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare kryesore ose i dhënë si informacion shpjegues në shënimet

19 **Disa Standarde të Kontabilitetit SNRF specifikojnë informacionin që kërkohet të paraqitet në pasqyrat financiare kryesore ose që jepet si informacion shpjegues në shënimet. Nuk është e nevojshme që njësia ekonomike të paraqesë një informacion specifik ose të japë informacion shpjegues specifik të kërkuar nga Standardet e Kontabilitetit SNRF nëse informacioni që rezulton nga kjo paraqitje apo dhënie informacionesh shpjeguese nuk është material. Kjo vlen edhe në rastin kur Standardet e Kontabilitetit SNRF përmbajnë një listë me kërkesa specifike ose i përshkruajnë ato si kërkesat minimale.**

20 **Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë atëherë kur pajtueshmëria me kërkesa të caktuara të Standardeve të Kontabilitetit SNRF nuk është e mjaftueshme për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë ndikimin e transaksioneve, si dhe të ngjarjeve dhe kushteve të tjera, në pozicionin financiar dhe performancën financiare të saj.**

Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare kryesore

21 Paragrafi 16 përcakton se roli i pasqyrave financiare kryesore është që të sigurojë përmbledhje të strukturuara, të cilat janë të dobishme për qëllimet e cilësuara në atë paragraf (referuar këtu e në vijim si *përmbledhje e dobishme e strukturuar*). Njësia ekonomike do të përdorë rolin e pasqyrave financiare kryesore për të përcaktuar informacionin material për t'u paraqitur në këto pasqyra, siç theksohet në paragrafët 22–24.

22 **Për të siguruar përmbledhje të strukturuar të dobishme në një pasqyrë financiare kryesore, njësia ekonomike do të plotësojë kërkesat specifike që përcaktojnë strukturën e pasqyrës. Kërkesat specifike janë:**

(a) për pasqyrën e fitimit ose humbjes—kërkesat në paragrafët 47, 69, 76 dhe 78;

(b) për pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse—kërkesat në paragrafët 86–88;

(c) për pasqyrën e pozicionit financiar—kërkesat në paragrafët 96 dhe 104;

(d) për pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto—kërkesat në paragrafin 107; dhe

(e) për pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare—kërkesat në paragrafin 10 të SNK 7.

23 **Disa Standarde të Kontabilitetit SNRF kërkojnë që nënzëra specifikë të paraqiten veçmas në pasqyrat financiare kryesore (për shembull paragrafët 75 dhe 103 të këtij Standardi). Nëse paraqitja veçmas nuk është e nevojshme që pasqyra të japë një përmbledhje të strukturuar të dobishme, nuk është e nevojshme që njësia ekonomike të paraqesë veçmas një nënzë në një pasqyrë financiare kryesore. Kjo vlen edhe në rastin kur Standardet e Kontabilitetit SNRF përmbajnë një listë me nënzëra specifikë të kërkuar ose i përshkruajnë nënzërat si kërkesa minimale (shih paragrafin B8).**

24 **Njësia ekonomike do të paraqesë nënzëra dhe nëntotale shtesë nëse paraqitje të tilla janë të nevojshme që një pasqyrë financiare kryesore të japë një përmbledhje të strukturuar të dobishme. Nëse njësia ekonomike paraqet nënzëra ose nëntotale shtesë, këto nënzëra ose nëntotale do të (shih paragrafin B9):**

(a) përfshijnë shumat e njohura dhe të matura në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF;

(b) jenë të krahasueshme me strukturën e pasqyrës së krijuar nga kërkesat e renditura në paragrafin 22;

(c) të jenë të qëndrueshme nga periudha në periudhë, në përputhje me paragrafin 30; dhe

(d) paraqiten në mënyrë jo më të dukshme se totalet dhe nëntotalet e kërkuara nga Standardet e Kontabilitetit SNRF.

Identifikimi i pasqyrave financiare

25 **Një njësi ekonomike duhet të identifikojë qartë pasqyrat financiare dhe t'i dallojë ato nga informacioni tjetër në të njëjtin dokument të publikuar (shih paragrafin B10).**

26 Standardet e Kontabilitetit SNRF zbatohen vetëm për pasqyrat financiare dhe jo domosdoshmërisht për informacionin tjetër të paraqitur në një raport vjetor, në një raport për rregullatorët apo në ndonjë dokument tjetër. Prandaj është e rëndësishme që përdoruesit e pasqyrave financiare të mund të dallojnë informacionin e përgatitur sipas Standardeve të Kontabilitetit SNRF nga informacioni tjetër që mund të jetë i dobishëm për përdoruesit, por nuk është objekt i këtyre kërkesave.

27 **Një njësi ekonomike duhet të identifikojë qartë çdo pasqyrë financiare kryesore dhe shënimet shpjeguese. Përveç kësaj, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në mënyrë të dukshme dhe ta përsërisë atë kur është e nevojshme për një kuptim të saktë të informacionit të paraqitur:**

(a) për emrin e njësisë ekonomike raportuese ose mjete të tjera identifikimi, si dhe ndonjë ndryshim në këtë informacion nga data e fundit e periudhës paraardhëse të raportimit;

(b) nëse pasqyrat financiare mbulojnë njësi ekonomike individuale ose një grup njësish ekonomike;

(c) për datën e fundit të periudhës së raportimit ose periudhën e mbuluar nga pasqyrat financiare;

(d) për monedhën e paraqitjes, siç përkufizohet në SNK 21 *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit*; dhe

(e) nivelin e rrumbullakimeve të përdorura në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare (shih paragrafin B11).

Frekuenca e raportimit

28 **Njësia ekonomike duhet të paraqesë një paketë të plotë të pasqyrave financiare të paktën një herë në vit. Nëse një njësi ekonomike ndryshon datën e mbylljes së periudhës së saj të raportimit dhe i paraqet pasqyrat financiare për një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër se një vit, njësia ekonomike do duhet të japë si informacion shpjegues përveç periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare:**

(a) arsyen e përdorimit të një periudhe më të gjatë ose më të shkurtër; dhe

(b) faktin se shumat e paraqitura në pasqyrat financiare nuk janë plotësisht të krahasueshme.

29 Normalisht, një njësi ekonomike përgatit rregullisht pasqyra financiare për një periudhë një-vjeçare. Megjithatë, për arsye praktike, disa njësi ekonomike preferojnë të raportojnë, për shembull, për një periudhë 52 javore. Ky standard nuk e përjashton këtë praktikë.

Qëndrueshmëria e paraqitjes, e dhënies së informacioneve shpjeguese dhe e klasifikimit

30 **Një njësi ekonomike duhet të ruajë paraqitjen, dhënien e informacioneve shpjeguese dhe *klasifikimin* e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën përveç nëse:**

(a) të jetë evidente, që pas një ndryshimi të rëndësishëm në natyrën e operacioneve të njësisë ose një rishikimi të pasqyrave të saj financiare, një tjetër paraqitje, dhënie informacionesh shpjeguese ose klasifikim do të ishte më i përshtatshëm duke patur parasysh kriteret për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në SNK 8 *Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare* (shih paragrafin B12); ose

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) një Standard Kontabiliteti SNRF kërkon një ndryshim në paraqitje, dhënie informacionesh shpjeguese ose klasifikim.

Informacioni krahasues

31 **Me përjashtim të rastit kur lejohet ose kërkohet ndryshe nga Standardet e Kontabilitetit SNRF, një njësi ekonomike duhet të japë informacion krahasues (d.m.th. informacion në lidhje me periudhën e mëparshme të raportimit) për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Njësia ekonomike duhet të përfshijë informacion krahasues për informacionin tregues dhe përshkrues nëse ai është i rëndësishëm për të kuptuar pasqyrat financiare të periudhës aktuale (shih paragrafin B13).**

32 **Njësia ekonomike do të paraqesë një periudhë raportimi aktuale dhe një periudhë të mëparshme në secilën prej pasqyrave financiare kryesore të saj dhe në shënimet shpjeguese. Paragrafët B14–B15 paraqesin kërkesat e lidhur me informacionin krahasues shtesë.**

Ndryshime në politikat kontabël, riparaqitja në retrospektivë ose riklasifikimi

33 **Nëse një njësi ekonomike ndryshon paraqitjen, dhënien e informacioneve shpjeguese ose klasifikimin e zërave në pasqyrat e saj financiare, ajo do të riklasifikojë shumat krahasuese përveç rastit kur riklasifikimi është i pazbatueshëm. Kur njësia ekonomike riklasifikon shumat krahasuese, ajo do të japë informacion shpjegues (përfshirë edhe çeljen e periudhës paraardhëse) për:**

(a) natyrën e riklasifikimit;

(b) shumën e çdo zëri ose klase të zërave të riklasifikuar; dhe

(c) arsyen e riklasifikimit.

34 **Nëse riklasifikimi i shumave krahasuese është i pazbatueshëm, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues lidhur me:**

(a) arsyen e mos riklasifikimit të shumave; dhe

(b) për natyrën e rregullimeve që do të duhet të ishin bërë nëse shumat do të ishin riklasifikuar.

35 Përmirësimi i krahasueshmërisë së informacionit ndërmjet periudhave ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare në marrjen e vendimeve ekonomike, veçanërisht duke lejuar vlerësimin e prirjeve në informacion për qëllime parashikuese. Në disa rrethana është i pazbatueshëm riklasifikimi i informacionit krahasues për një periudhë të caktuar paraardhëse, për të arritur qëndrueshmërinë me periudhën aktuale. Për shembull, në periudhën(periudhat) e mëparshme një njësi ekonomike mund të mos i ketë grumbulluar të dhënat në një mënyrë të tillë që lejon riklasifikimin dhe mund të mos jetë praktike rikrijimi i informacionit.

36 SNK 8 trajton rregullimet që kërkohen për informacionin krahasues kur një njësi ekonomike ndryshon një politikë kontabël ose korrigjon një gabim.

37 **Njësia ekonomike do të paraqesë një pasqyrë të tretë të pozicionit financiar në çelje të periudhës paraardhëse, përveç informacionit krahasues të kërkuar në paragrafët 31–32, nëse:**

(a) ajo zbaton një politikë kontabël në mënyrë retrospektive, bën një riparaqitje në retrospektivë të zërave në pasqyrat financiare të saj ose riklasifikon zërat në pasqyrat financiare të saj; dhe

(b) zbatimi retrospektiv, riparaqitja në retrospektivë ose riklasifikimi ka një efekt material në informacionin e pasqyrës së pozicionit financiar në çelje të pasqyrës paraardhëse.

38 Në rrethanat e përshkruara në paragrafin 37 një njësi ekonomike do të paraqesë tre pasqyra të pozicionit financiar—një pasqyrë të pozicionit financiar në:

(a) fund të periudhës aktuale të raportimit;

(b) fund të periudhës paraardhëse; dhe

(c) çelje të periudhës paraardhëse.

39 Kur një njësie ekonomike i kërkohet të paraqesë një pasqyrë të tretë të pozicionit financiar në zbatim të paragrafit 37, njësia duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 33–36 dhe SNK 8. Megjithatë, nuk është e nevojshme që njësia të paraqesë shënimet shpjeguese përkatëse të pasqyrës së pozicionit financiar në çelje të periudhës paraardhëse.

40 Data e kësaj pasqyre të tretë të pozicionit financiar do të jetë ajo e çeljes së periudhës paraardhëse pavarësisht nëse pasqyrat financiare të njësisë ekonomike paraqesin informacion krahasues për periudha më të hershme (siç lejohet në paragrafët B14–B15).

Grupimi dhe ndarja

Parimet e grupimit dhe të ndarjes

41 **Për qëllime të këtij Standardi, një zë është një aktiv, një detyrim, një instrument i kapitalit neto ose rezervë, një e ardhur, një shpenzim ose një fluks i mjeteve monetare ose çdo *grupim* apo ndarje e aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve ose flukseve monetare të tilla. Një nënzë është një zë që paraqitet veçmas në pasqyrat financiare kryesore. Informacion material tjetër mbi zërat jepet si informacion shpjegues në shënimet. Përveçse kur kjo do të anashkalonte kërkesat specifike të grupimit ose ndarjes sipas Standardeve të Kontabilitetit SRNF, një njësi ekonomike do të (shih paragrafët B16–B23):**

(a) klasifikojë dhe grupojë aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare në zëra, bazuar në karakteristikat e përbashkëta;

(b) ndajë zërat bazuar në karakteristikat që nuk janë të përbashkëta;

(c) grupojë ose ndajë zërat për të paraqitur nënzëra në pasqyrat financiare kryesore që përmbushin rolin e pasqyrave financiare kryesore në sigurimin e përmbledhjeve të strukturuara të dobishme (shih paragrafin 16);

(d) grupojë ose ndajë zërat për të dhënë informacionin shpjegues në shënimet që përmbush rolin e shënimeve shpjeguese në sigurimin e informacionit material (shih paragrafin 17); dhe

(e) sigurojë që grupimi dhe ndarja në pasqyrat financiare nuk fsheh informacion material (shih paragrafin B3).

42 Në zbatim të parimeve në paragrafin 41, një njësi ekonomike do të ndajë zërat nëse informacioni do të rezultojë material. Nëse, duke zbatuar paragrafin 41(c), njësia ekonomike nuk paraqet informacion material në pasqyrat financiare kryesore, ajo do të japë informacion shpjegues në shënimet. Paragrafët B79 dhe B111 paraqesin shembuj të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve dhe zëra të kapitalit neto me karakteristika mjaftueshëm jo të ngjashme për të cilat paraqitja në pasqyrën e fitimit ose humbjes, në pasqyrën e pozicionit financiar apo dhënia e informacionit shpjegues në shënimet është e nevojshme për të siguruar informacion material.

43 **Një njësi ekonomike do të emërtojë dhe përshkruajë zërat e paraqitur në pasqyrat financiare kryesore (dmth totalet, nëntotalet dhe nënzërat) ose zërat e informacionit shpjegues të dhënë në shënimet, në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e zërit (shih paragrafët B24–B26). Për të paraqitur në mënyrë besnike një zë, njësia ekonomike do të japë të gjitha përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme që zëri të kuptohet nga një përdorues i pasqyrave financiare. Në disa raste, njësia ekonomike mund të ketë nevojë të përfshijë në përshkrimet dhe shpjegimet kuptimin e termave që njësia përdor dhe informacion mbi mënyrën sesi i ka grupuar apo ndarë aktivet, detyrimet, kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare.**

Kompensimi

44 **Një njësi ekonomike nuk duhet të kompensojë aktivet dhe detyrimet ose të ardhurat dhe shpenzimet, me përjashtim të rastit kur kjo gjë kërkohet ose lejohet nga një Standard i Kontabilitetit SNRF (shih paragrafët B27–B28).**

45 Njësia ekonomike raporton më vete si aktivet dhe detyrimet, ashtu edhe të ardhurat dhe shpenzimet. Kompensimi në pasqyrën (at) e performancës financiare ose në pasqyrën e pozicionit financiar, me përjashtim të rastit kur kompensimi reflekton thelbin e transaksionit ose të një ngjarjeje tjetër, pakëson aftësinë e përdoruesve për të kuptuar transaksionet, ngjarjet dhe kushtet e tjera që kanë ndodhur dhe për të vlerësuar flukset e ardhshme monetare të njësisë ekonomike. Matja e aktiveve për vlerën neto nga zbritjet e vlerësuara—për shembull, zbritjet për amortizimin moral të inventarëve dhe zbritjet për humbjet e pritshme të kredisë në aktivet financiare—nuk është kompensim.

Pasqyra e fitimit ose humbjes

46 **Një njësi ekonomike duhet të përfshijë të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të periudhës raportuese në pasqyrën e fitimit ose humbjes përveçse kur një Standard i Kontabilitetit SNRF kërkon ose lejon ndryshe (shih paragrafët 88–95 dhe B86).**

 © Fondacioni i SNRF-ve

Kategoritë në pasqyrën e fitimit ose humbjes

47 **Njësia ekonomike do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet e përfshira në pasqyrën e fitimit ose humbjes në një nga pesë kategoritë (shih paragrafin B29):**

(a) kategoria e shfrytëzimit (shih paragrafin 52);

(b) kategoria investuese (shih paragrafët 53–58);

(c) kategoria financiare (shih paragrafët 59–66);

(d) kategoria e tatimeve mbi të ardhurat (shih paragrafin 67); dhe

(e) kategoria e operacioneve jo të vijueshme (shih paragrafin 68).

48 Paragrafët 52–68 paraqesin kërkesat për klasifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në kategoritë e shfrytëzimit, investimit, financimit, e tatimeve mbi të ardhurat dhe të operacioneve jo të vijueshme. Gjithashtu, paragrafët B65–B76 paraqesin kërkesat sesi klasifikohen sipas kategorive diferencat nga kurset e këmbimit, fitimi ose humbja në pozicionin monetar neto, si dhe fitimet dhe humbjet nga derivativët dhe instrumentat mbrojtës të dedikuar.

Njësitë ekonomike me aktivitete kryesore biznesi të specifikuara

49 Për të klasifikuar të ardhurat dhe shpenzimet në kategoritë e shfrytëzimit, investuese dhe financiare, njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse ka një aktivitet kryesor biznesi të specifikuar—d.m.th. një aktivitet kryesor biznesi që (shih paragrafët B30–B41):

(a) investon në lloje të veçanta aktivesh, referuar këtu e në vijim si investim në aktive (shih paragrafin 53); ose

(b) ofron financim për klientët.

50 Në zbatim të paragrafëve 55–58 dhe 65–66, njësia ekonomike me një aktivitet kryesor biznesi të specifikuar klasifikon në kategorinë e shfrytëzimit disa të ardhura që do të ishin klasifikuar në kategorinë investuese ose financiare nëse aktiviteti nuk do të ishte aktiviteti kryesor i biznesit.

51 Nëse njësia ekonomike:

(a) investon në aktive si një aktivitet kryesor biznesi, ajo do të japë informacion shpjegues mbi këtë fakt.

(b) ofron financim për klientët si një aktivitet kryesor biznesi, ajo do të japë informacion shpjegues mbi këtë fakt.

(c) identifikon një rezultat të ndryshëm nga vlerësimi i saj nëse investon në aktive apo ofron financim për klientët si aktiviteti kryesor i biznesit (shih paragrafin B41), ajo do të japë informacion shpjegues për:

(i) faktin që rezultati i vlerësimit ka ndryshuar dhe datën e ndryshimit.

(ii) shumën dhe klasifikimin e zërave të të ardhurave dhe të shpenzimeve para dhe pas datës së ndryshimit në rezultatin e vlerësimit në periudhën aktuale, si dhe shumën dhe klasifikimin në periudhën paraardhëse për zërat për të cilët klasifikimi ka ndryshuar për shkak të rezultatit të ndryshuar të vlerësimit, me përjashtim të rastit kur kjo nuk është praktike për t'u realizuar. Nëse njësia ekonomike nuk jep informacionin shpjegues sepse është praktikisht e pamundur, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Kategoria e shfrytëzimit

52 **Njësia ekonomike do të klasifikojë në kategorinë e shfrytëzimit të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e përfshira në pasqyrën e fitimit ose humbjes që nuk janë klasifikuar në (shih paragrafin B42):**

(a) kategorinë investuese;

(b) kategorinë financiare;

(c) kategorinë e tatimeve mbi të ardhurat; ose

(d) kategorinë e operacioneve jo të vijueshme.

Kategoria investuese

53 **Me përjashtim të sa kërkohet në paragrafët 55–58 për një njësi ekonomike që ka një aktivitet kryesor biznesi të specifikuar, njësia ekonomike do të klasifikojë në kategorinë investuese të ardhurat dhe shpenzimet e specifikuara në paragrafin 54, nga:**

(a) investimet në pjesëmarrje, në sipërmarrjet e përbashkëta dhe në filialet e pakonsoliduara (shih paragrafët B43–B44);

(b) mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare; dhe

(c) aktive të tjera nëse ato gjenerojnë kthime individuale dhe kryesisht të pavarura nga burimet e tjera të njësisë ekonomike (shih paragrafët B45–B49).

54 **Të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivet e identifikuara në paragrafin 53 që njësia ekonomike do të klasifikojë në kategorinë investuese përfshijnë shumat e paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes për (shih paragrafin B47):**

(a) të ardhurat e gjeneruara nga aktivet;

(b) të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga matja fillestare dhe e mëpasshme e aktiveve, përfshirë çregjistrimin e aktiveve; dhe

(c) shpenzimet rritëse të ngarkueshme drejtpërdrejt tek blerja dhe nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve—për shembull, kostot e transaksionit dhe kostos e shitjes së aktiveve.

Njësitë ekonomike me aktivitete kryesore biznesi të specifikuara

55 Për aktivet e specifikuara në paragrafin 53(a) (që janë investime në pjesëmarrje, sipërmarrje të përbashkëta dhe filiale të pakonsoliduara) që njësia ekonomike ekonomike i investon si aktivitet kryesor biznesi (shih paragrafin B38), ajo duhet të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet e specifikuara në paragrafin 54:

(a) në kategorinë investuese nëse aktivet trajtohen duke zbatuar metodën e kapitalit neto (shih paragrafët B43(a) dhe B44(a)); ose

(b) në kategorinë e shfrytëzimit nëse aktivet trajtohen duke zbatuar metodën e kapitalit neto (shih paragrafët B43(b)–(c) dhe B44(b)–(c)).

56 Për aktivet e specifikuara në paragrafin 53(b) (që janë mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare), njësia ekonomike do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet e specifikuara në paragrafin 54 në kategorinë investuese me përjashtim të rastit kur:

(a) ajo investon si aktivitet kryesor biznesi në aktive financiare që janë brenda objektit të paragrafit 53(c)—në këtë rast ajo do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet në kategorinë e shfrytëzimit.

(b) ajo nuk plotëson kërkesat në (a), por ofron financim për klientët si aktivitet kryesor të biznesit—në këtë rast ajo do të klasifikojë:

(i) të ardhurat dhe shpenzimet nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare që lidhen me ofrimin e financimit për klientët, për shembull mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare të mbajtura për kërkesat rregullatore—në kategorinë e shfrytëzimit.

(ii) të ardhurat dhe shpenzimet nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare që nuk lidhen me ofrimin e financimit për klientët—duke zbatuar një politikë kontabël të zgjedhur për të klasifikuar të ardhurat dhe shpenzimet e specifikuara në paragrafin 54 në kategorinë e shfrytëzimit ose në kategorinë investuese. Zgjedhja e politikës kontabël duhet të jetë e qëndrueshme me zgjedhjen e bërë nga njësia ekonomike për politikën kontabël përkatëse për të ardhurat dhe shpenzimet nga detyrimet në paragrafin 65(a)(ii).

57 Nëse një njësi ekonomike kur zbaton paragrafin 56(b) nuk mund të dallojë mes mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare të përshkruar në paragrafët 56(b)(i) dhe 56(b)(ii), ajo do të zbatojë politikën kontabël të zgjedhur në paragrafin 56(b)(ii) për të klasifikuar të ardhurat dhe shpenzimet nga të gjitha mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në kategorinë e shfrytëzimit.

58 Për aktivet e specifikuara në paragrafin 53(c) (që janë aktive të tjera nëse ata gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike) që një njësi ekonomike i investon si aktivitet kryesor biznesi (shih paragrafin B40), njësia ekonomike duhet të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet e specifikuara në paragrafin 54 në kategorinë e shfrytëzimit.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Kategoria financiare

59 **Për të përcaktuar se cilat të ardhura dhe shpenzime duhen klasifikuar në kategorinë financiare, një njësi ekonomike duhet të dallojë mes:**

(a) detyrimeve të lindura nga transaksione që përfshijnë vetëm marrje financimi (shih paragrafët B50–B51); dhe

(b) detyrimeve të tjera të ndryshme nga ato të përshkruara në (a)—d.m.th. detyrimet e lindura nga transaksione që nuk përfshijnë vetëm marrjen e financimit (shih paragrafin B53).

60 **Për detyrimet e specifikuara në paragrafin 59(a) (d.m.th. detyrimet e lindura nga transaksione që përfshijnë vetëm marrjen e financimit), me përjashtim të sa përcaktohet në paragrafët 63–66, njësia ekonomike do të klasifikojë në kategorinë financiare shumat e përfshira në pasqyrën e fitimit ose humbjes për:**

(a) të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga matja fillestare dhe e mëpasshme e detyrimeve, përfshirë çregjistrimin e detyrimeve (shih paragrafin B52); dhe

(b) shpenzimet rritëse të ngarkueshme drejtpërdrejt tek emetimi dhe shlyerja e detyrimeve—për shembull, kostot e transaksionit.

61 **Për detyrimet e specifikuara në paragrafin 59(b) (d.m.th. detyrimet e lindura nga transaksione që nuk përfshijnë vetëm marrjen e financimit), me përjashtim të sa përcaktohet në paragrafët 63–64, njësia ekonomike do të klasifikojë në kategorinë financiare:**

(a) të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi, por vetëm nëse njësia ekonomike identifikon të ardhura dhe shpenzime të tilla me qëllim zbatimin e kërkesave të Standardeve të Kontabilitetit SNRF; dhe

(b) të ardhurat dhe shpenzimet e lindura nga ndryshimet në normat e interesit, por vetëm nëse njësia ekonomike identifikon të ardhura dhe shpenzime të tilla me qëllim zbatimin e kërkesave të tjera të Standardeve të Kontabilitetit SNRF.

62 Paragrafët B56–B57 paraqesin sesi një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat në paragrafët 59–61 tek kontratat hibride që përfshijnë një detyrim bazë.

63 Kërkesat në paragrafët 60–61 nuk zbatohen për fitimet dhe humbjet nga derivativët dhe instrumentet mbrojtës të përcaktuar. Njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët B70–B76 për të klasifikuar fitime dhe humbje të tilla.

64 Njësia ekonomike do të përjashtojë nga kategoria financiare dhe do të klasifikojë në kategorinë e shfrytëzimit:

(a) të ardhurat dhe shpenzimet nga kontratat e investimit të emetuara me tipare pjesëmarrjeje të njohura duke zbatuar SNRF 9 *Instrumentet Financiarë* (shih paragrafin B58); dhe

(b) të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga sigurimi të përfshira në pasqyrën e fitimit ose humbjes duke zbatuar SNRF 17 *Kontratat e Sigurimit*.

Njësitë ekonomike me aktivitete kryesore biznesi të specifikuar

65 Nëse një njësi ekonomike ofron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi, ajo do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet (shih paragrafin B59):

(a) nga detyrimet e specifikuara në paragrafin 59(a) (d.m.th. detyrimet e lindura nga transaksione që përfshijnë vetëm marrjen e financimit):

(i) nëse detyrimet lidhen me ofrimin e financimit për klientët—në kategorinë e shfrytëzimit.

(ii) nëse detyrimet nuk lidhen me ofrimin e financimit për klientët—duke zbatuar një politikë kontabël të zgjedhur për të klasifikuar të ardhurat dhe shpenzimet e specifikuara në paragrafin 60 në kategorinë e shfrytëzimit ose në kategorinë investuese. Zgjedhja e politikës kontabël duhet të jetë e qëndrueshme me zgjedhjen e bërë nga njësia ekonomike për politikën kontabël përkatëse për të ardhurat dhe shpenzimet nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në paragrafin 56(b)(ii).

(b) nga detyrimet e specifikuara në paragrafin 59(b) (d.m.th. detyrimet e lindura nga transaksione që nuk përfshijnë vetëm marrjen e financimit):

(i) nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë specifikuar në paragrafin 61—në kategorinë financiare; ose

(ii) nëse të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë specifikuar në paragrafin 61—në kategorinë e shfrytëzimit.

66 Nëse njësia ekonomike kur zbaton paragrafin 65(a) nuk mund të dallojë mes detyrimeve të përshkruara në paragrafët 65(a)(i) dhe 65(a)(ii), ajo do të zbatojë politikën kontabël të zgjedhur në paragrafin 65(a)(ii) për të klasifikuar të ardhurat dhe shpenzimet nga të gjitha detyrime të tilla në kategorinë e shfrytëzimit.

Kategoria e tatimeve mbi të ardhurat

67 Një njësi ekonomike do të klasifikojë në kategorinë e tatimeve mbi të ardhurat shpenzimin ose të ardhurën tatimore që përfshihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në zbatim të SNK 12 *Tatimet mbi të Ardhurat*, si dhe çdo diferencë përkatëse nga kurset e këmbimit (shih paragrafët B65–B68).

Kategoria e operacioneve jo të vijueshme

68 Një njësi ekonomike do të klasifikojë në kategorinë e operacioneve jo të vijueshme të ardhurat dhe shpenzimet nga operacione jo të vijueshme siç kërkohet SNRF 5 *Aktive Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Veprimtaritë jo të Vijueshme*.

Totalet dhe nëntotalet për t'u paraqitur në pasqyrën e fitimit ose humbjes

69 **Një njësi ekonomike do të paraqesë totalet dhe nëntotalet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për:**

(a) ***fitimin ose humbjen e shfrytëzimit*** **(shih paragrafin 70);**

(b) ***fitimin ose humbjen para financimit dhe tatimet mbi të ardhurat*** **(shih paragrafin 71), objekt i paragrafit 73; dhe**

(c) fitimin ose humbjen (shih paragrafin 72).

70 Fitimi ose humbja e shfrytëzimit përmban të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit.

71 Fitimi ose humbja para financimit dhe tatimet mbi të ardhurat përmban:

(a) fitimin ose humbjen e shfrytëzimit; dhe

(b) të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në kategorinë investuese.

72 Fitimi ose humbja është totali i të ardhurave minus shpenzimet, i përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Si rezultat, ai përfshin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në të gjitha kategoritë e pasqyrës së fitimit ose humbjes (shih paragrafin 47).

73 Njësia ekonomike nuk do të zbatojë paragrafin 69(b) nëse zbaton politikën kontabël të paraqitur në paragrafin 65(a)(ii) për klasifikimin në kategorinë e shfrytëzimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga detyrimet që nuk lidhen me ofrimin e financimit për klientët. Megjithatë, një njësi ekonomike e tillë do të zbatojë paragrafin 24 për të përcaktuar nëse duhet të paraqesë një nëntotal shtesë pas fitimit të shfrytëzimit dhe para kategorisë financiare. Për shembull, njësia ekonomike do të paraqesë një nëntotal për fitimin ose humbjen e shfrytëzimit dhe të ardhurat dhe shpenzimet nga investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto, nëse njësia ekonomike përcakton se kjo është e nevojshme për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme të të ardhurave dhe shpenzimeve të saj.

74 Nëse njësia ekonomike e përshkruar në paragrafin 73 paraqet një nëntotal shtesë që përfshin fitimin ose humbjen e shfrytëzimit dhe të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në kategorinë investuese, ajo nuk duhet të emërtojë nëntotalin në një mënyrë që nënkupton se nëntotali përjashton shumat financiare, si p.sh. 'fitimi para financimit'. Kur zbaton paragrafin 43, njësia ekonomike do të emërtojë nëntotalin në një mënyrë që paraqet me besnikëri shumat e përfshira në nëntotal.

Zërat për t'u paraqitur në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose për t'u dhënë si informacion shpjegues në shënimet

75 **Një njësi ekonomike do të paraqesë në pasqyrën e fitimit ose humbjes nënzëra për (shih paragrafin B77):**

(a) shumat e kërkuara nga ky Standard, konkretisht:

(i) të ardhurat, duke paraqitur veçmas nënzërat e përshkruar në (b)(i) dhe (c)(i);

 © Fondacioni i SNRF-ve

(ii) shpenzimet e shfrytëzimit, duke paraqitur veçmas nënzërat siç kërkohet nga paragrafët 78 dhe 82(a);

(iii) pjesën e fitimit ose humbjes nga pjesëmarrjet dhe shoqëritë e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto;

(iv) shpenzimin ose të ardhurën nga tatimi mbi të ardhurat; dhe

(v) një shumë të vetme për totalin e veprimtarive jo të vijueshme (shih SNRF 5);

(b) shumat e kërkuara nga SNRF 9, konkretisht:

(i) të ardhurën nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv;

(ii) humbjet nga zhvlerësimi (duke përfshirë anulimet e humbjeve ose fitimeve nga zhvlerësimi) të përcaktuara në përputhje me Seksionin 5.5 të SNRF 9;

(iii) fitimet ose humbjet që vijnë nga çregjistrimi i aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar;

(iv) çdo fitim ose humbje që vjen nga diferenca mes vlerës së drejtë të një aktivi financiar dhe kostos së tij të mëparshme të amortizuar në datën e riklasifikimit nga matja me koston e amortizuar në matjen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe

(v) çdo fitim ose humbje të akumuluar të njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse që është riklasifikuar në fitim ose humbje në datën e riklasifikimit të një aktivi financiar nga matja me vlerën e drejtë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse tek matja me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes; dhe

(c) shumat e kërkuara nga SNRF 17, konkretisht:

(i) të ardhurën nga sigurimi;

(ii) shpenzimet e shërbimit të sigurimit nga kontratat e emetuara brenda objektit të SNRF 17;

(iii) të ardhurat ose shpenzimet nga kontratat e risigurimit të mbajtura;

(iv) të ardhurat ose shpenzimet financiare të sigurimit nga kontratat e emetuara brenda objektit të SNRF 17; dhe

(v) të ardhurat ose shpenzimet financiare nga kontratat e risigurimit të mbajtura.

76 **Njësia ekonomike duhet të paraqesë në pasqyrën e fitimit ose humbjes (jashtë kategorive të përshkruara në paragrafin 47) një shpërndarje të fitimit ose humbjes për periudhën raportuese që u takon:**

(a) interesave jokontrollues; dhe

(b) *pronarëve* të shoqërisë mëmë.

77 Paragrafët B78–B79 paraqesin kërkesat sesi njësia ekonomike përdor gjykimin për të përcaktuar nëse duhet të paraqesë nënzëra shtesë në pasqyrën e fitimit ose humbjes apo duhet të japë informacion shpjegues në shënimet.

Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese mbi shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit

78 **Një njësi ekonomike do të klasifikojë në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes, dhe do të paraqesë shpenzimet në nënzëra në mënyrë që të sigurojë përmbledhjen e strukturuar më të dobishme për shpenzimet e saj, duke përdorur një ose të dyja karakteristikat në vijim (shih paragrafët B80–B85):**

(a) natyrën e shpenzimeve; ose

(b) funksionin e shpenzimeve brenda njësisë ekonomike.

79 Çdo nënzë individual do të përmbajë shpenzimet e shfrytëzimit të grupuara në bazë të vetëm njërës prej këtyre karakteristikave, por e njëjta karakteristikë nuk mund të përdoret si bazë për grupimin e të gjithë nënzërave (shih paragrafin B81).

80 Kur klasifikohen shpenzimet sipas natyrës ('shpenzime sipas natyrës'), njësia ekonomike siguron informacion mbi shpenzimet e shfrytëzimit të lidhura me natyrën e burimeve ekonomike të konsumuara për të realizuar aktivitetet e njësisë ekonomike, pa i'u referuar aktiviteteve në lidhje me të cilat këto burime

ekonomike janë konsumuar. Një informacion i tillë përfshin informacionin mbi shpenzimet për lëndët e para, shpenzimet për përfitimet e punonjësve, zhvlerësimin dhe amortizimin.

81 Kur klasifikohen shpenzimet sipas funksionit brenda njësisë ekonomike, njësia ekonomike shpërndan dhe grupon shpenzimet e shfrytëzimit në përputhje me aktivitetin me të cilin lidhen burimet e konsumuara. Për shembull, kostot e shitjeve janë një nënzë funksioni që kombinon shpenzimet e lidhura me prodhimin ose aktivitete të tjera-gjeneruese të të ardhurave të një njësie ekonomike të tilla si: shpenzime për lëndë të para, shpenzime për përfitimet e punonjësve, zhvlerësimin dhe amortizimin. Prandaj kur klasifikohen shpenzimet sipas funksionit, njësia ekonomike mund të:

(a) shpërndajë në nënzëra funksioni të ndryshëm (të tillë si kosto e shitjeve dhe të kërkim-zhvillimit) shpenzime që lidhen me burime ekonomike me natyrë të njëjtë (të tilla si shpenzime për përfitimet e punonjësve); dhe

(b) të përfshijë në një nënzë funksioni të vetëm një shpërndarje shpenzimesh që lidhet me burime ekonomike të natyrave të ndryshme (të tilla si shpenzime për lëndët e para, shpenzime për përfitimet e punonjësve, zhvlerësimin dhe amortizimin).

82 Nëse një njësi ekonomike paraqet një ose më shumë nënzëra që përmbajnë shpenzime të klasifikuara sipas funksionit në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes, ajo duhet të:

(a) paraqesë një nënzë të veçantë për koston e saj të shitjeve, nëse njësia ekonomike klasifikon shpenzimet e shfrytëzimit në funksione që përfshijnë një kosto të funksionit të shitjeve. Ky nënzë do të përfshijë totalin e shpenzimeve për inventarin të përshkruara në paragrafin 38 të SNK 2 *Inventarët*.

(b) japë si informacion shpjegues një përshkrim cilësor mbi natyrën e shpenzimeve të përfshira në secilin prej nënzërave sipas funksionit.

83 **Nëse njësia ekonomike paraqet një ose më shumë nënzëra që përmbajnë shpenzime të klasifikuara sipas funksionit në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes, ajo duhet gjithashtu të japë informacion shpjegues në një shënim të vetëm për:**

(a) totalin e secilit (në vijim):

(i) amortizimin, përfshirë shumat për të cilat duhet të jepet informacion shpjegues sipas paragrafit 73(e)(vii) të SNK 16 *Aktivet Afatgjata Materiale (Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje)*, paragrafit 79(d)(iv) të SNK 40 *Aktive Afatgjata Materiale të Investuara* dhe paragrafit 53(a) të SNRF 16 *Qiratë*;

(ii) amortizimin e aktiveve jomateriale, përfshirë shumat për të cilat duhet të jepet informacion shpjegues sipas paragrafit 118(e)(vi) të SNK 38 *Aktivet Jomateriale*;

(iii) përfitimet e punonjësve, përfshirë shumën për përfitimet e punonjësve të njohur nga njësia ekonomike kur zbaton SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve* dhe shumën për shërbimet e marra nga punonjësit, të njohur nga njësia ekonomike kur zbaton SNRF 2 *Pagesa të Bazuara në Aksione*;

(iv) humbje nga zhvlerësimi dhe anulimet e humbjeve nga zhvlerësimi, përfshirë shumat për të cilat duhet të jepet informacion shpjegues sipas paragrafëve 126(a) dhe 126(b) të SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve*; dhe

(v) zhvlerësimet dhe anulimet e zhvlerësimeve për inventarët, përfshirë shumat për të cilat duhet të jepet informacion shpjegues sipas paragrafëve 36(e) dhe 36(f) të SNK 2; dhe

(b) për secilin total të renditur në (a)(i)–(v):

(i) shumën që lidhet me secilin nënzë të kategorisë së shfrytëzimit (shih paragrafin B84); dhe

(ii) një listë të secilit nënzë jashtë kategorisë së shfrytëzimit që përfshin gjithashtu shumat e lidhura me totalin.

84 Paragrafi 41 kërkon që njësia ekonomike të shpërndajë zërat për të siguruar informacion material. Megjithatë, një njësi ekonomike që zbaton paragrafin 83 përjashtohet nga dhënia e informacioneve shpjeguese:

(a) në lidhje me nënzërat sipas funksionit të paraqitur në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes—informacioni i shpërndarë mbi shumat e shpenzimeve sipas natyrës të përfshira në secilin nënzë, përtej shumave të specifikuara në paragrafin 83; dhe

(b) në lidhje me shpenzimet sipas natyrës, për të cilat kërkohet dhënie informacionesh shpjeguese në mënyrë specifike nga një Standard i Kontabilitetit SNRF—informacion të shpërndarë mbi shumat

 © Fondacioni i SNRF-ve

e shpenzimeve të përfshira në secilin nënzë sipas funksionit të paraqitur në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes, përtej shumave të specifikuara në paragrafin 83.

85 Përjashtimi nga paragrafi 84 lidhet me shpërndarjen e shpenzimeve të shfrytëzimit. Megjithatë, kjo nuk e përjashton njësinë ekonomike nga zbatimi i kërkesave specifike për dhënie informacionesh shpjeguese lidhur me këto shpenzime në Standardet e Kontabilitetit SNRF.

Pasqyra që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse

86 **Një njësi ekonomike do të paraqesë në pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse, totalet për:**

(a) fitimin ose humbjen;

(b) të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (shih paragrafët B86–B87); dhe

(c) të ardhurat gjithëpërfshirëse, si shumë e totalit të fitimit ose humbjes me të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

87 **Njësia ekonomike do të paraqesë një shpërndarje të të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën e raportimit që u takon:**

(a) interesave jokontrollues; dhe

(b) pronarëve të shoqërisë mëmë.

Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse

88 **Njësia ekonomike do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet e përfshira në pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse në një nga dy kategoritë:**

(a) të ardhura dhe shpenzime që do të riklasifikohen në fitim ose humbje kur plotësohen kushte të caktuara; dhe

(b) të ardhura dhe shpenzime që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje.

89 **Njësia ekonomike do të paraqesë në secilën kategori të pasqyrës që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse, nënzëra për:**

(a) pjesën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto; dhe

(b) çdo zë tjetër të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

90 **Njësia ekonomike duhet të paraqesë në pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse ose jep informacion shpjegues në shënimet për *rregullime të riklasifikimit* që lidhen me përbërësit e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (shih paragrafët B88–B89).**

91 Standarde të tjera të Kontabilitetit SNRF specifikojnë nëse dhe kur shumat e përfshira më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, riklasifikohen në fitim ose humbje. Këto riklasifikime referohen në këtë Standard si rregullime të riklasifikimit. Njësia ekonomike përfshin një rregullim të riklasifikimit me përbërësin përkatës të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në periudhën kur ky rregullim është riklasifikuar në fitim ose humbje. Njësia ekonomike mund të ketë përfshirë këto shuma në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse si fitime të parealizuara në periudhat aktuale ose të mëparshme. Njësia ekonomike duhet të zbresë këto nga të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në periudhën në të cilën fitimet e realizuara janë riklasifikuar në fitim ose humbje për të shmangur përfshirjen e tyre dy herë në të ardhurat gjithëpërfshirëse totale.

92 Një njësi ekonomike që jep informacion shpjegues mbi rregullime të riklasifikimit në shënimet shpjeguese, do të paraqesë në pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse pas efektit të rregullimeve riklasifikuese përkatëse.

93 **Njësia ekonomike duhet të paraqesë ose në pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse ose të japë informacion shpjegues në shënimet shoqëruese mbi shumën e tatimeve mbi të ardhurat që lidhen me secilin zë të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, duke përfshirë rregullimet e riklasifikimit (shih paragrafët 61A dhe 63 të SNK 12).**

94 Njësia ekonomike mund të paraqesë zëra të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ose:

(a) në vlerën neto lidhur me efektin tatimor përkatës; ose

(b) para efektit tatimor përkatës së bashku me një shumë që tregon shumën totale të tatimeve mbi të ardhurat të këtyre zërave.

95 Nëse njësia ekonomike zgjedh alternativën në paragrafin 94(b), ajo do të shpërndajë tatimin (efektin tatimor) mes kategorive të paraqitura në paragrafin 88.

Pasqyra e pozicionit financiar

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata

96 **Një njësi duhet të paraqesë aktivet afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata, si klasifikime të veçanta në pasqyrën e saj të pozicionit financiar në përputhje me paragrafët 99–102, përveçse kur një paraqitje e bazuar në likuiditet siguron një përmbledhje të strukturuar më të dobishme. Nëse zbatohet ky përjashtim, njësia ekonomike duhet të paraqesë të gjitha aktivet dhe detyrimet sipas nivelit të likuiditetit (shih paragrafët B90–B93).**

97 **Pavarësisht metodës së paraqitjes të përdorur, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për shumën që pritet për t'u rikuperuar ose për t'u shlyer pas më shumë se 12 muajve për çdo nënzë aktivesh dhe detyrimesh që kombinon shumat e pritshme për t'u rikuperuar ose shlyer:**

(a) jo më shumë se 12 muaj pas periudhës raportuese; dhe

(b) më shumë se 12 muaj pas periudhës raportuese.

98 **Kur një njësi ekonomike paraqet aktive afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe detyrime afatshkurtra dhe afatgjata, si klasifikime individuale në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, ajo nuk duhet t'i klasifikojë aktivet (detyrimet) e tatimit të shtyrë si aktive (detyrime) afatshkurtra.**

Aktivet afatshkurtra

99 **Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër nëse (shih paragrafët B94–B95):**

(a) pret që aktivi të realizohet ose të mbahet për shitje ose konsum brenda ciklit normal të shfrytëzimit;

(b) e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi;

(c) pret që aktivi të realizohet brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit; ose

(d) aktivi është në formën e mjeteve monetare ose ekuivalentit të mjeteve monetare (siç përkufizohet në SNK 7), me përjashtim të rastit kur ai kufizohet për t'u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën 12 muaj pas periudhës raportuese.

100 Njësia ekonomike do të klasifikojë të gjitha aktivet e tjera, të ndryshme nga ato të specifikuara në paragrafin 99 si aktive afatgjata.

Detyrimet afatshkurtra

101 **Njësia ekonomike do ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur:**

(a) pret të shlyejë detyrimin gjatë ciklit normal të shfrytëzimit (shih paragrafët B96 dhe B107–B108);

(b) e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtare (shih paragrafin B97);

(c) detyrimi duhet të shlyhet brenda 12 muajve pas periudhës raportuese (shih paragrafët B97–B98 dhe B107–B108); ose

(d) nuk ka të drejtë në fund të periudhës raportuese për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas periudhës së raportimit (shih paragrafët B99–B108).

102 Njësia ekonomike do të klasifikojë të gjitha detyrimet e tjera, të ndryshme nga ato të specifikuara në paragrafin 101 si detyrime afatgjata.

Zërat për t'u paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar ose për t'u dhënë si informacion shpjegues në shënimet

103 **Një njësi ekonomike do të paraqesë në pasqyrën e pozicionit financiar nënzëra për:**

(a) aktivet afatgjata materiale;

(b) aktivet afatgjata materiale të investuara;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(c) aktivet afat gjata jo materiale;

(d) emri i mirë;

(e) aktivet financiare (duke përjashtuar shumat e treguara në (g), (j) dhe (k));

(f) portofolet e kontratave brenda objektit të SNRF 17 që janë aktive, të ndara siç kërkohet nga paragrafi 78 i SNRF 17;

(g) investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto;

(h) aktivet biologjike të cilat janë brenda objektit të SNK 41 *Bujqësia*;

(i) inventarët;

(j) llogari të arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera të arkëtueshme;

(k) mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare;

(l) totalin e aktiveve të klasifikuara si të mbajtura për shitje dhe aktiveve të përfshira në grupet e nxjerrjes jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5;

(m) llogari të pagueshme tregtare dhe llogari të tjera të pagueshme;

(n) provizionet;

(o) detyrimet financiare (duke përjashtuar shumat e paraqitura në (m) dhe (n));

(p) portofolet e kontratave brenda objektit të SNRF 17 që janë detyrime, të ndara siç kërkohet nga paragrafi 78 i SNRF 17;

(q) detyrimet dhe aktivet për tatimin aktual, siç përcaktohet në SNK 12;

(r) detyrimet dhe aktivet për tatimin e shtyrë, siç përcaktohet në SNK 12; dhe

(s) detyrimet e përfshira në grupet e nxjerrjes jashtë përdorimit të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5.

104 **Njësia ekonomike do të paraqesë në pasqyrën e pozicionit financiar nënzëra për:**

(a) interesave jokontrollues; dhe

(b) kapitalin e emetuar dhe rezervat që i atribuohen zotëruesve të shoqërisë mëmë.

105 Paragrafët B109–B111 paraqesin kërkesat sesi një njësi ekonomike përdor gjykimin për të përcaktuar nëse duhet të paraqesë nënzëra shtesë në pasqyrën e pozicionit financiar apo duhet të japë informacion shpjegues në shënimet.

106 Në pajtim me paragrafin 96, ky Standard nuk përshkruan renditjen ose formatin sipas të cilit njësia ekonomike duhet të paraqesë zërat në pasqyrën e pozicionit financiar. Gjithashtu, përshkrimet e përdorura dhe renditja e zërave ose grupeve të zërave të ngjashëm mund të ndryshohet në përputhje me natyrën e njësisë ekonomike dhe të transaksioneve të saj, për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme të aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit neto të njësisë ekonomike. Për shembull, një institucion financiar mund të ndryshojë përshkrimet në paragrafin 103 për të siguruar një paraqitje të strukturuar të dobishme të aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit neto të institucionit financiar.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto

Informacioni që paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto

107 **Njësia ekonomike duhet të paraqesë një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto siç kërkohet nga paragrafi 10. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto do të përfshijë:**

(a) të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për periudhën raportuese, duke treguar veçmas shumat totale që u takojnë pronarëve të shoqërisë mëmë dhe shumat që u takojnë interesave jokontrolluese;

(b) për çdo përbërës të kapitalit neto, efektet e zbatimit retrospektiv ose riparaqitjen retrospektive të njohur në përputhje me SNK 8; dhe

(c) për çdo përbërës të kapitalit neto, një rakordim në mes vlerës kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës, duke paraqitur veçmas (të paktën) ndryshimet që rezultojnë nga:

(i) fitimin ose humbjen;

(ii) të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse; dhe

(iii) transaksionet me pronarët në cilësinë e tyre si pronarë, duke treguar veçmas kontributet nga pronarët dhe shpërndarjet për pronarët, si dhe ndryshimet në interesat e pronësisë në filiale të cilat nuk çojnë në një humbje të kontrollit.

108 SNK 8 kërkon rregullime në retrospektivë për të reflektuar ndryshimet në politikat kontabël deri në masën që është e zbatueshme, me përjashtim kur kushtet kalimtare të një Standardi tjetër të Kontabilitetit SNRF kërkojnë ndryshe. Gjithashtu, SNK 8 kërkon që riparaqitjet për korrigjimin e gabimeve të bëhen në retrospektivë deri në masën që është e zbatueshme. Rregullimet dhe riparaqitjet në retrospektivë nuk janë ndryshime në kapital neto, por janë rregullime në tepricën e çeljes së fitimeve të pashpërndara me përjashtim të rastit kur Standardet e Kontabilitetit SNRF kërkojnë rregullime në retrospektivë të një përbërësi tjetër të kapitalit neto. Paragrafi 107(b) kërkon që njësia ekonomike të paraqesë veçmas në pasqyrën e ndryshimeve në kapital të rregullimit total të secilit përbërës të kapitalit neto që rezulton nga ndryshimet në politikat kontabël dhe veçmas nga korrigjimet e gabimeve. Njësia ekonomike duhet t'i paraqesë këto rregullime për çdo periudhë raportimi paraardhëse dhe për fillimin e periudhës.

Informacioni që paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose që duhet të jepet si informacion shpjegues në shënimet

109 **Për çdo përbërës të kapitalit neto njësia ekonomike duhet të paraqesë, ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose të japë informacion shpjegues në shënime, një analizë të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse sipas zërit (shih paragrafin 107(c)(ii)).**

110 **Njësia ekonomike duhet të paraqesë, ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose të japë informacion shpjegues në shënimet, shumat e dividendëve të njohura si shpërndarje për pronarët gjatë periudhës raportuese, si dhe shumat përkatëse të dividendëve për aksion.**

111 Në paragrafin 107, përbërësit e kapitalit neto përfshijnë, për shembull, secilën klasë të kapitalit neto të kontribuar, tepricën e akumuluar të secilës klasë të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe fitimet e pashpërndara.

112 Ndryshimet në kapitalin neto të njësisë ekonomike mes fillimit dhe fundit të periudhës raportuese tregojnë rritjen ose pakësimin në aktivet neto të saj gjatë periudhës. Me përjashtim të ndryshimeve që vijnë nga transaksionet me zotëruesit e kapitalit neto që veprojnë si të tillë (si p.sh. kontributet e kapitalit neto, riblerjet e instrumenteve të kapitalit të vet dhe të dividendëve të njësisë ekonomike) dhe kostove të transaksionit të lidhura drejtpërdrejt me transaksione të tilla, ndryshimi i përgjithshëm në kapitalin neto gjatë një periudhe përfaqëson shumën totale të të ardhurave dhe shpenzimeve, përfshirë fitimet dhe humbjet e gjeneruara nga aktivitetet e njësisë ekonomike gjatë asaj periudhe.

Shënimet shpjeguese

Struktura

113 **Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në shënimet shpjeguese për:**

(a) informacionin në lidhje me bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (shih paragrafët 6A–6N të SNK 8) dhe politikat kontabël specifike të përdorura (shih paragrafët 27A–27I të SNK 8);

(b) informacionin e kërkuar nga Standardet e Kontabilitetit SNRF që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare kryesore; dhe

(c) informacionin tjetër që nuk është paraqitur në pasqyrat financiare kryesore, por është i nevojshëm për të kuptuar secilën prej tyre(shih paragrafin 20).

114 **Njësia ekonomike duhet t'i paraqesë shënimet shpjeguese në mënyrë të organizuar, për sa është e mundur(shih paragrafin B112). Kur përcakton një mënyrë organizimi, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë efektin në kuptueshmërinë dhe krahasueshmërinë e pasqyrave të saj financiare. Njësia ekonomike duhet të kryqëzojë referencat e çdo zëri në pasqyrat financiare kryesore me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Nëse shumat e dhëna si informacion shpjegues në shënimet janë përfshirë në një ose më shumë zëra në pasqyrat financiare kryesore, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në shënimet për zërin (at) në të cilin janë përfshirë shumat.**

 © Fondacioni i SNRF-ve

115 **Njësia ekonomike mund t'i paraqesë shënimet që japin informacion shpjegues mbi bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave specifike kontabël të përdorura, si një pjesë e veçantë e pasqyrave financiare.**

116 **Njësia ekonomike do të japë informacionin shpjegues vijues në shënimet, nëse ky informacion nuk është paraqitur diku tjetër në informacionin e publikuar me pasqyrat financiare:**

(a) adresën dhe formën ligjore të njësisë ekonomike, vendin e regjistrimit dhe adresën e zyrës së saj të regjistruar (ose vendin kryesor të biznesit nëse është i ndryshëm nga zyra e regjistruar);

(b) një përshkrim të natyrës së operacioneve të njësisë ekonomike dhe aktiviteteve kryesore të saj;

(c) emrin e shoqërisë mëmë dhe emrin e shoqërisë mëmë të fundit për grupin; dhe

(d) nëse është një njësi ekonomike me jetëgjatësi të kufizuar, informacion mbi jetëgjatësinë e saj.

Matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi

Identifikimi i matësve të performancës të përcaktuar nga drejtimi

117 **Një *matës performance i përcaktuar nga drejtimi* është një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që (shih paragrafët B113–B122):**

(a) njësia ekonomike përdor në komunikimet publike jashtë pasqyrave financiare;

(b) njësia ekonomike përdor për të komunikuar tek përdoruesit e pasqyrave financiare këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi; dhe

(c) nuk është renditur në paragrafin 118, ose kërkohet në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF.

118 Nëntotalet e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi janë:

(a) fitimi ose humbja bruto (të ardhurat minus koston e shitjeve) dhe nëntotale të ngjashme (shih paragrafin B123);

(b) fitimi ose humbja e shfrytëzimit para amortizimit dhe zhvlerësimit brenda objektit të SNK 36;

(c) fitimi ose humbja e shfrytëzimit dhe të ardhurat dhe shpenzimet nga të gjitha investimet që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto;

(d) për një njësi ekonomike që zbaton paragrafin 73, një nëntotal që përmban fitimin ose humbjen e shfrytëzimit dhe të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në kategorinë investuese;

(e) fitimi ose humbja para tatimeve mbi të ardhurat; dhe

(f) fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme.

119 **Një njësi ekonomike do të supozojë se një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që ajo përdor në komunikimin publik jashtë pasqyrave të saj financiare u komunikon përdoruesve të pasqyrave financiare këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi, me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi 120 dhe njësia ekonomike e kundërshton supozimin.**

120 Njësia ekonomike lejohet të kundërshtoj supozimin e përshkruar në paragrafin 119 dhe të deklarojë që një nëntotal nuk komunikon këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi, por vetëm nëse ajo ka informacion të arsyeshëm dhe mbështetës që tregon bazën për atë deklaratë (shih paragrafët B124–B131).

Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi

121 **Objektivi i dhënies së informacioneve shpjeguese mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi është që njësia ekonomike të sigurojë informacion që ndihmon një përdorues të pasqyrave financiare të kuptojë:**

(a) aspektin e performancës financiare që në këndvështrimin e drejtimit komunikohet nga matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi; dhe

(b) sesi matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi krahasohet me matësit e përcaktuar nga Standardet e Kontabilitetit SNRF.

122 **Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese mbi të gjithë matësit që plotësojnë përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi në paragrafin 117 në një shënim të vetëm (shih paragrafët B132–B133). Ky shënim duhet të përfshijë një deklaratë që matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi japin këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi dhe nuk janë domosdoshmërisht të krahasueshëm me matësit që kanë emërtime ose përshkrime të ngjashme të dhëna nga njësi ekonomike të tjera.**

123 **Njësia ekonomike do të emërtojë dhe përshkruajë secilin matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme që nuk çorienton përdoruesit e pasqyrave financiare (shih paragrafët B134–B135). Për secilin matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi, njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues:**

(a) një përshkrim të aspektit të performancës financiare që në këndvështrimin e drejtimit, komunikohet nga matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi. Ky përshkrim duhet të përfshijë shpjegimin përse, në këndvështrimin e drejtimit, matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi siguron informacion të dobishëm mbi performancën financiare të njësisë ekonomike.

(b) sesi llogaritet matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi.

(c) një rakordim mes matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi dhe nëntotalit më të krahasueshëm të renditur në paragrafin 118 ose totalin apo nëntotalin e kërkuar në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF (shih paragrafët B136–B140).

(d) efektin e tatimit mbi të ardhurat (të përcaktuar duke zbatuar paragrafin B141) dhe efektin e interesave jokontrolluese për secilin zë që jepet si informacion shpjegues në rakordimin e kërkuar në (c).

(e) një përshkrim sesi njësia ekonomike zbaton paragrafin B141 për të përcaktuar efektin e tatimit mbi të ardhurat të kërkuar në (d).

124 Nëse njësia ekonomike ndryshon llogaritjen e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi, shton një matës të ri të performancës të përcaktuar nga drejtimi, ndalon së përdoruri një matës të mëparshëm të performancës të përcaktuar nga drejtimi ose ndryshon përcaktimin e efekteve të tatimit mbi të ardhurat në zërat e rakorduar të kërkuar nga paragrafi 123(d), ajo duhet të japë si informacion shpjegues:

(a) një sqarim që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë ndryshimin, shtesën apo ndalesën dhe efektet e tij.

(b) arsyet e ndryshimit, shtesës apo ndalesës.

(c) informacion krahasues të riparaqitur për të pasqyruar ndryshimin, shtesën apo ndalesën me përjashtim të rastit kur kjo nuk është praktike për t'u bërë. Zgjedhja e bërë nga njësia ekonomike në lidhje me matësin e performancës të përcaktuar nga drejtimi nuk është një zgjedhje e politikës kontabël. Pavarësisht nga kjo, kur vlerëson nëse riparaqitja e informacionit krahasues nuk është praktike, njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat në paragrafët 50–53 të SNK 8.

125 Nëse njësia ekonomike nuk jep informacionin shpjegues mbi informacionin krahasues të riparaqitur të kërkuar nga paragrafi 124(c), sepse kjo është praktikisht e pazbatueshme, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Kapitali

126 **Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë objektivat, politikat dhe proceset e njësisë ekonomike për administrimin e kapitalit.**

127 Për t'u përmbajtur paragrafit 126, njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues në shënimet:

(a) informacion cilësor lidhur me objektivat, politikat dhe proceset e administrimit të kapitalit të saj, duke përfshirë:

(i) një përshkrim se çfarë ajo administron si kapital;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(ii) nëse njësia ekonomike është objekt i kërkesave të detyrueshme nga jashtë lidhur me kapitalin, natyrën e këtyre kërkesave dhe si këto kërkesa janë përfshirë në administrimin e kapitalit; dhe

(iii) sesi po i plotëson objektivat e saj për administrimin e kapitalit.

(b) të dhëna sasiore për atë çfarë njësia ekonomike administron si kapital. Disa njësi ekonomike shohin disa detyrime financiare (për shembull disa forma të borxhit të nënrenditur) si pjesë e kapitalit. Njësi të tjera ekonomike e shohin kapitalin pa disa përbërës të kapitalit neto (për shembull përbërësit që vijnë nga mbrojtja e fluksit monetar).

(c) çdo ndryshim në (a) dhe (b) kundrejt periudhës paraardhëse raportuese.

(d) nëse gjatë periudhës raportuese ka plotësuar ndonjë nga kërkesat për kapitalin për të cilat është e detyruar nga jashtë.

(e) nëse njësia ekonomike nuk ka plotësuar ndonjë kërkesë të tillë të detyrueshme nga jashtë për kapitalin, pasojat e këtij mosplotësimi.

128 Njësia ekonomike duhet të mbështesë dhënien e informacioneve shpjeguese në shënime të paragrafit 127, në informacionin e siguruar së brendshmi për personelin kryesor drejtues.

129 Njësia ekonomike mund të administrojë kapitalin në disa mënyra dhe mund të jetë objekt i një numri kërkesash të ndryshme për kapitalin. Për shembull, një konglomerat mund të përfshijë njësi ekonomike që ndërmarrin aktivitete siguruese dhe bankare dhe këto njësi ekonomike mund të veprojnë në vende me legjislacione të ndryshme. Nëse dhënia e informacioneve shpjeguese të grupuara lidhur me kërkesat për kapitalin dhe sesi është administruar kapitali, nuk do të sigurojë informacion të dobishëm ose çorienton përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar burimet e kapitalit të një njësie ekonomike, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues veçmas për çdo kërkesë për kapitalin të cilës duhet t'i nënshtrohet njësia ekonomike.

Dhënia e informacioneve të tjera shpjeguese

130 **Një njësi ekonomike duhet të paraqesë ose në pasqyrën e pozicionit financiar, ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapital, ose të japë si informacion shpjegues në shënimet:**

(a) për secilën klasë të kapitalit aksionar:

(i) numrin e aksioneve të autorizuara;

(ii) numrin e aksioneve të emetuara dhe plotësisht të paguara, ose të emetuara por jo plotësisht të paguara;

(iii) vlerën nominale për aksion, ose një deklaratë që aksionet nuk kanë vlerë nominale;

(iv) një rakordim të numrit të aksioneve në qarkullim gjendje në fillim dhe në fund të periudhës raportuese;

(v) të drejtat, preferencat dhe kufizimet të lidhura me atë klasë duke përfshirë kufizimet në shpërndarjen e dividendëve dhe në ripagimin e kapitalit;

(vi) aksionet e njësisë ekonomike të mbajtura nga vetë njësia ekonomike ose nga filialet apo pjesëmarrjet e saj; dhe

(vii) aksionet e rezervuara për t'u emetuar sipas opsioneve dhe kontratave për shitjen e aksioneve, përfshirë afatet dhe shumat; dhe

(b) një përshkrim i natyrës dhe qëllimit të çdo rezerve brenda kapitalit neto.

131 **Njësia ekonomike pa kapital aksionar, të tilla si një bashkëpronësi ose trust, duhet të japë informacion shpjegues ekuivalent me atë të kërkuar nga paragrafi 130(a), duke treguar ndryshimet gjatë periudhës raportuese në secilën kategori të interesit në kapitalin neto, si dhe të drejtat, preferencat dhe kufizimet për secilën kategori të interesit në kapitalin neto.**

132 **Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në shënimet shpjeguese për:**

(a) shumën e dividendëve të propozuar ose të deklaruar përpara se të miratohen për t'u publikuar pasqyrat financiare, por të panjohura si një shpërndarje ndaj zotëruesve të kapitalit neto gjatë periudhës raportuese, si dhe shumën përkatëse për aksion; dhe

(b) shumën e dividendëve preferencialë të akumuluar e të panjohur ende.

Shtojca A
Termat e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit të Kontabilitetit SNRF.

grupimi Mbledhja së bashku e aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve ose flukseve të mjeteve monetare, që kanë karakteristika të përbashkëta dhe janë përfshirë në të njëjtin klasifikim.

klasifikimi Klasifikimi i aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve të mjeteve monetare në zëra, bazuar në karakteristikat e përbashkëta.

ndarja Zbërthimi i një zëri në pjesë përbërëse që kanë karakteristika jo të përbashkëta.

raporte financiare për qëllime të përgjithshme Raporte që japin informacion financiar mbi njësinë ekonomike raportuese, i cili është i dobishëm për përdoruesit kryesorë në vendimmarrjen lidhur me sigurimin e burimeve për njësinë ekonomike. Këto vendime përfshijnë:

(a) blerjen, shitjen ose mbajtjen e instrumenteve të kapitalit neto dhe të borxhit;

(b) dhënien ose shlyerjen e huave dhe formave të tjera të kredisë; ose

(c) ushtrimin e të drejtave për të votuar ose ndikuar ndryshe në veprimet e drejtimit të njësisë ekonomike, që ndikojnë përdorimin e burimeve ekonomike të saj.

Raporte financiare për qëllime të përgjithshme përfshijnë—por nuk kufizohen me—pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme të njësisë ekonomike dhe dhënie informacionesh shpjeguese financiare mbi qëndrueshmërinë.

pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme Një formë e veçantë e *raporteve financiare për qëllime të përgjithshme* që japin informacion mbi aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat dhe shpenzimet e njësisë ekonomike raportuese.

Standarde të Kontabilitetit SNRF Standardet e kontabilitetit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Ato përfshijnë:

(a) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;

(b) Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit;

(c) Interpretimet e KIRFN; dhe

(d) Interpretimet e KIS.

Standardet e Kontabilitetit SNRF më parë njiheshin si Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF, SNRF-të dhe Standardet SNRF.

matës i performancës i përcaktuar nga drejtimi Një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që:

(a) njësia ekonomike përdor në komunikimet publike jashtë pasqyrave financiare;

(b) njësia ekonomike përdor për të komunikuar tek përdoruesit e pasqyrave financiare këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi; dhe

(c) nuk është renditur në paragrafin 118 të SNRF 18, ose kërkohet në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF.

informacion material Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike raportuese të caktuar.

shënimet Informacion shtesë i dhënë në pasqyrat financiare, përtej informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare kryesore.

 © Fondacioni i SNRF-ve

fitimi ose humbja e shfrytëzimit Totali i të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit.

të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse Zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve (duke përfshirë rregullimet e riklasifikimeve) që janë njohur jashtë fitimit ose humbjes siç kërkohet ose lejohet nga Standardet e tjera të Kontabilitetit SNRF.

pronarë Mbajtës të së drejtës për kërkesa të klasifikuara si kapital neto.

pasqyra financiare kryesore Pasqyra(at) e performancës financiare, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyra e ndryshimeve në flukset e mjeteve monetare.

fitimi ose humbja Totali i të ardhurave minus shpenzimet, i përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

fitimi ose humbja para financimit dhe tatimeve mbi të ardhurat Totali i fitimit ose humbjes së shfrytëzimit dhe të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të klasifikuara në kategorinë investuese.

rregullime të riklasifikimit Shumat e riklasifikuara në fitimin ose humbjen e periudhës aktuale të raportimit të cilat kanë qenë njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në periudhat aktuale ose të mëparshme.

totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse Ndryshimi në kapitalin neto gjatë një periudhe raportimi që rezulton nga transaksionet dhe ngjarje të tjera, përveç atyre ndryshimeve që vijnë nga transaksionet me pronarët në rolin e tyre si pronarë.

përmbledhje e strukturuar e dobishme Një përmbledhje e strukturuar e dhënë në pasqyrat financiare kryesore mbi aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat dhe shpenzimet e njohura të një njësie ekonomike raportuese që është e dobishme për:

(a) patur një pamje të kuptueshme të aktiveve, të detyrimeve, të kapitalit neto, të të ardhurave, të shpenzimeve dhe të flukseve monetare të njohura për një njësi ekonomike;

(b) të bërë krahasime mes njësive ekonomike dhe mes periudhave raportuese për të njëjtën njësi ekonomike; dhe

(c) identifikuar zërat ose fushat rreth të cilave përdoruesit e pasqyrave financiare mund të dëshirojnë të kërkojnë informacion shtesë në shënimet shpjeguese.

Shtojca B
Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit të Kontabilitetit SNRF. Ajo përshkruan zbatimin e paragrafëve 1–132 dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të Standardit të Kontabilitetit SNRF.

Kërkesat e përgjithshme për pasqyrat financiare

Materialiteti

B1 Informacioni është material nëse mungesa, paraqitja e gabuar ose e paqartë, ka pritshmëri të arsyeshme të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme mund të marrin në bazë të atyre pasqyrave financiare, të cilat japin informacion financiar rreth një njësie ekonomike raportuese të caktuar.

B2 Materialiteti varet nga natyra ose madhësia e informacionit, ose të dyja bashkë. Një njësi ekonomike vlerëson nëse informacioni, individualisht ose në kombinim me informacione të tjera, është material në kontekstin e pasqyrave financiare të marra në tërësi.

B3 Informacioni është i paqartë nëse komunikohet në një mënyrë që do të kishte një efekt të ngjashëm për përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare sikur të mos ishte dhënë fare apo të ishte dhënë me gabime. Në vijim jepen disa shembuj të rrethanave që mund të rezultojnë në fshehjen e informacionit që është material:

(a) informacioni material në lidhje me një zë, transaksion ose ngjarje tjetër është dhënë në pasqyrat financiare, por gjuha e përdorur është e mjegullt ose e paqartë;

(b) informacioni material në lidhje me një zë, transaksion apo ngjarje tjetër është i shpërndarë në të gjitha pasqyrat financiare;

(c) zëra, transaksione ose ngjarje të tjera pa ngjashmëri mes tyre janë grupuar në mënyrë të papërshtatshme;

(d) zëra, transaksione ose ngjarje të tjera të ngjashme mes tyre janë raportuar të ndara në mënyrë të papërshtatshme; dhe

(e) kuptueshmëria e pasqyrave financiare reduktohet si pasojë e fshehjes së informacionit të rëndësishëm nga informacione jo të rëndësishme në masën që një përdorues kryesor nuk është në gjendje të përcaktojë se cili informacion është material dhe cili jo.

B4 Kur vlerësohet nëse ka pritshmëri të arsyeshme që një informacion mund të ndikojë në vendimet e marra nga përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të një njësie raportuese të caktuar, kërkohet që njësia ekonomike të marrë parasysh karakteristikat e këtyre përdoruesve, ndërkohë që duhet të marrë parasysh edhe rrethanat e vetë njësisë ekonomike.

B5 Shumë investitorë ekzistues dhe potencialë, huadhënës dhe kreditorë të tjerë nuk mund t'i kërkojnë njësisë ekonomike raportuese të japë informacion në mënyrë të drejtpërdrejtë për ta, por duhet të bazohen në pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme për shumicën e informacionit financiar që ata kanë nevojë. Rrjedhimisht, ata janë përdoruesit kryesorë, të cilëve i'u drejtohen këto pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme. Pasqyrat financiare hartohen për përdoruesit të cilët kanë njohuri të arsyeshme të biznesit dhe të veprimtarive ekonomike dhe që shqyrtojnë dhe analizojnë informacionin me kujdes. Në të njëjtën kohë, edhe përdoruesit e mirëinformuar dhe të kujdesshëm mund të kenë nevojë të kërkojnë ndihmën e një këshilltari për të kuptuar informacionin në lidhje me dukuritë ekonomike komplekse.

Roli i pasqyrave financiare kryesore dhe i shënimeve shpjeguese

B6 Kur zbaton paragrafin 17(a), një njësi ekonomike jep në shënimet informacionin e nevojshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar nënzërat e paraqitur në pasqyrat financiare kryesore. Shembuj të informacionit të tillë përfshijnë:

(a) ndarjen e nënzërave të paraqitur në pasqyrat financiare kryesore;

(b) përshkrimi i karakteristikave të nënzërave të paraqitur në pasqyrat financiare kryesore; dhe

(c) informacion mbi metodat, supozimet dhe gjykimet e përdorura në njohjen, matjen dhe paraqitjen e zërave të përfshirë në pasqyrat financiare kryesore.

 © Fondacioni i SNRF-ve

B7 Kur zbaton paragrafin 17(b), njësia ekonomike plotëson pasqyrat financiare kryesore me informacion shtesë të nevojshëm për të realizuar objektivin e pasqyrave financiare—që është:

(a) informacioni i kërkuar në mënyrë specifike nga Standardet e Kontabilitetit SNRF (shih paragrafin 19)—për shembull:

(i) informacioni i kërkuar nga SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara* mbi aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara dhe të panjohura të një njësie ekonomike; dhe

(ii) informacioni i kërkuar nga SNRF 7 *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese* mbi ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj tipeve të ndryshme të rreziqeve si rreziku i tregut, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i kredisë; dhe

(b) informacioni shtesë i kërkuar në mënyrë specifike nga Standardet e Kontabilitetit SNRF (shih paragrafin 20).

Informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare kryesore

B8 Paragrafi 23 shpjegon se nuk është e nevojshme që njësia ekonomike të paraqesë veçmas një nënzë në një pasqyrë financiare kryesore nëse nuk është e nevojshme që pasqyra të japë një përmbledhje të strukturuar të dobishme, edhe nëse nënzëri kërkohet nga Standardet e Kontabilitetit SNRF. Për shembull, nuk është e nevojshme që njësia ekonomike të paraqesë një nënzë të cilësuar në paragrafin 75, nëse nuk është e nevojshme që pasqyra e fitimit ose humbjes të japë një përmbledhje të strukturuar të dobishme të të ardhurave dhe shpenzimeve, ose një nënzë të cilësuar në paragrafin 103 nëse nuk është e nevojshme që pasqyra e pozicionit financiar të japë një përmbledhje të strukturuar të dobishme të aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit neto. Nëse një njësi ekonomike nuk paraqet nënzërat e renditur në paragrafët 75 dhe 103, ajo duhet të japë informacion shpjegues mbi zërat në shënimet nëse informacioni që rezulton është material (shih paragrafin 42).

B9 Anasjelltas, kur zbaton paragrafin 24, njësia ekonomike do të paraqesë nënzëra shtesë ndaj atyre të cilësuar në paragrafët 75 dhe 103 nëse paraqitje të tilla janë të nevojshme që pasqyra e fitimit ose humbjes të sigurojë një përmbledhje të strukturuar të dobishme të të ardhurave dhe shpenzimeve ose që pasqyra e pozicionit financiar të sigurojë një përmbledhje të strukturuar të dobishme të aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit neto (shih paragrafët B78–B79 dhe B109–B111).

Identifikimi i pasqyrave financiare

B10 Paragrafi 25 kërkon që një njësi ekonomike të identifikojë qartë pasqyrat financiare dhe t'i dallojë ato nga informacioni tjetër në të njëjtin dokument të publikuar. Njësia ekonomike i plotëson këto kërkesa nëpërmjet paraqitjes së përshtatshme të titujve për faqet, pasqyrat, shënimet, kolonat dhe të ngjashme. Për të përcaktuar mënyrën më të mirë të paraqitjes së këtij informacioni është i nevojshëm të përdoret gjykimi. Për shembull, nëse një njësi ekonomike i paraqet pasqyrat financiare në mënyrë elektronike, ajo merr në konsideratë mënyra të tjera për të plotësuar kërkesat—për shembull, duke etiketuar si duhet në mënyrë dixhitale informacionin e dhënë në pasqyrat financiare.

B11 Shpesh, njësia ekonomike i bën më të kuptueshme pasqyrat financiare nëpërmjet paraqitjes së informacionit në mijëra ose milionë njësi të monedhës së paraqitjes. Kjo praktikë është e pranueshme për sa kohë që njësia ekonomike jep informacion shpjegues mbi nivelin e rrumbullakimit dhe nuk heq informacionin material.

Qëndrueshmëria e paraqitjes, e dhënies së informacioneve shpjeguese dhe e klasifikimit

B12 Paragrafi 30(a) kërkon që njësia ekonomike të ndryshojë paraqitjen, dhënien e informacioneve shpjeguese ose klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nëse është e dukshme se do të ishte më e përshtatshme një paraqitje, dhënie informacionesh shpjeguese apo klasifikim tjetër. Për shembull, një blerje e rëndësishme ose një nxjerrje jashtë përdorimi, ose një rishikim i paraqitjes së pasqyrave financiare, mund të sugjerojë nevojën për ndryshim të pasqyrave financiare. Njësisë ekonomike i lejohet të ndryshojë paraqitjen, dhënien e informacioneve shpjeguese ose klasifikimin e zërave në pasqyrat e saj financiare vetëm nëse ndryshimi sjell informacion që është më i dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare dhe nëse njësia ekonomike ka më shumë mundësi të vijojë përdorimin e paraqitjes, dhënies së informacioneve shpjeguese apo klasifikimin e rishikuar, në mënyrë që nuk cënohet krahasueshmëria mes periudhave. Kur bën ndryshime të tilla, njësia ekonomike riklasifikon informacionin e saj krahasues në përputhje me paragrafët 33–34.

Informacioni krahasues

Informacioni krahasues i kërkuar

B13 Në disa raste informacioni përshkrues i dhënë në pasqyrat financiare për periudhën(at) raportuese paraardhëse vazhdon të jetë i rëndësishëm në periudhën aktuale. Për shembull, njësia ekonomike jep si informacion shpjegues në periudhën aktuale detajet e një çështjeje gjyqësore, rezultati i së cilës ishte i pasigurt në datën e fundit të periudhës së mëparshme dhe është ende e pazgjidhur. Përdoruesit e pasqyrave financiare mund të përfitojnë nga dhënia e informacionit shpjegues mbi faktin se pasiguria ekzistonte në datën e fundit të periudhës së mëparshme dhe nga dhënia e informacionit shpjegues mbi hapat që janë marrë gjatë periudhës për të zgjidhur pasigurinë.

Informacioni krahasues shtesë

B14 Një njësi ekonomike mund të paraqesë informacion krahasues shtesë përtej informacionit krahasues të kërkuar nga Standardet e Kontabilitetit SNRF, për aq sa ky informacion është përgatitur në përputhje me Standardet e Kontabilitetit SNRF. Ky informacion krahasues shtesë mund të përmbajë një ose më shumë prej pasqyrave financiare kryesore të referuara në paragrafin 10, por nuk ka nevojë të përfshijë një paketë të plotë pasqyrash financiare. Në këtë rast, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues në shënimet për këto pasqyra financiare kryesore shtesë.

B15 Për shembull, njësia ekonomike mund të paraqesë një pasqyrë të tretë (ose pasqyra) të performancës financiare (pra, duke paraqitur periudhën raportuese aktuale, periudhën paraardhëse dhe një periudhë krahasuese shtesë). Megjithatë, njësisë ekonomike nuk i kërkohet të paraqesë një pasqyrë të tretë të pozicionit financiar, një pasqyrë të tretë të fluksit të mjeteve monetare ose një pasqyrë të tretë të ndryshimeve në kapitalin neto (pra, një pasqyrë financiare kryesore krahasuese shtesë). Njësisë ekonomike i kërkohet të japë informacion shpjegues në shënimet mbi informacionin krahasues që lidhet me atë pasqyrë(at) shtesë të performancës financiare.

Grupimi dhe ndarja

Parimet e grupimit dhe të ndarjes

Procesi i grupimit dhe i ndarjes

B16 Pasqyrat financiare janë rezultat i përpunimit të shumë transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera nga njësia ekonomike. Këto transaksione dhe ngjarje të tjera sjellin krijimin e aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve të mjeteve monetare.

B17 Për të zbatuar kërkesat e paragrafit 41, njësia ekonomike duhet të grupojë zërat bazuar në karakteristikat e përbashkëta (që do të thotë grupim i zërave që kanë karakteristika të ngjashme) dhe të ndajë zërat bazuar në karakteristikat që nuk janë të përbashkëta (që do të thotë ndarje e zërave që kanë karakteristika të ndryshme). Kur bën këtë, njësia ekonomike do të:

(a) identifikojë aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare që vijnë nga transaksione individuale ose ngjarje të tjera;

(b) klasifikojë dhe grupojë aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare në zëra bazuar në karakteristikat e tyre (për shembull, natyrën e tyre, funksionin e tyre, bazën e tyre të matjes ose një karakteristikë tjetër) në mënyrë që paraqitja e nënzërave në pasqyrat financiare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për zërat në shënimet të kenë të paktën një karakteristikë të përbashkët; dhe

(c) ndajë zërat bazuar në karakteristikat e ndryshme:

(i) në pasqyrat financiare kryesore, sipas nevojës për të siguruar përmbledhje të strukturuar të dobishme (siç përshkruhet në paragrafin 16); dhe

(ii) në shënimet shpjeguese, sipas nevojës për të siguruar informacion material (siç përshkruhet në paragrafin 17).

B18 Për të zbatuar parimet e grupimit dhe të ndarjes në paragrafin 41, njësia ekonomike mund të zbatojë hapat në paragrafët B17(a)–B17(c) në një rend të ndryshueshëm.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Bazat e grupimit dhe ndarjes

B19 Paragrafët B16–B18 shpjegojnë se njësia ekonomike përdor gjykimin e saj për të grupuar dhe ndarë aktivet, detyrimet, kapitalin neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare nga transaksione individuale dhe ngjarje të tjera bazuar në karakteristikat e përbashkëta dhe të ndryshme. Paragrafët B78 dhe B110 paraqesin shembuj të karakteristikave që një njësi ekonomike merr në konsideratë kur bën gjykimet e saj.

B20 Sa më të ngjashme të jenë karakteristikat e aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe të flukseve të mjeteve monetare, aq më shumë gjasa ka që grupimi i tyre të përmbushë rolin e pasqyrave financiare kryesore (d.m.th. të sigurojë përmbledhje të strukturuar të dobishme siç përshkruhet në paragrafin 16) ose të shënimeve shpjeguese (d.m.th. të sigurojë informacion material siç përshkruhet në paragrafin 17). Sa më të ndryshme të jenë karakteristikat e aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe të flukseve të mjeteve monetare, aq më shumë gjasa ka që ndarja e zërave do të përmbushë rolet e pasqyrave financiare kryesore ose të shënimeve shpjeguese.

B21 Zërat e grupuar dhe të paraqitur si nënzëra në pasqyrat financiare kryesore duhet të kenë të paktën një karakteristikë të përbashkët përveç plotësimit të përkufizimit të aktiveve, detyrimeve, kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe të flukseve të mjeteve monetare. Megjithatë, për shkak se roli i pasqyrave financiare kryesore është sigurimi i përmbledhjeve të strukturuara të dobishme, nënzërat në pasqyrat financiare kryesore ka mundësi që të grupojnë zëra që kanë karakteristika mjaftueshëm të ndryshme për të cilët është material informacioni për zëra të veçantë.

B22 Kur zbaton paragrafin 41, njësia ekonomike do të ndajë zërat që kanë karakteristika të ndryshme nëse informacioni që rezulton është material. Një karakteristikë e vetme e ndryshme mund të sjellë informacion material mbi zërat e ndarë.

B23 Për shembull, njësia ekonomike mund të paraqesë në pasqyrën e pozicionit financiar aktive që përfshijnë investime në tituj kapitali dhe investime në tituj borxhi veçmas nga aktivet jofinanciare. Aktivet financiare kanë karakteristika të ndryshme sepse kanë baza matjeje të ndryshme—disa maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes dhe të tjera aktive maten me koston e amortizuar. Njësia ekonomike mund të përcaktojë që për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme është e nevojshme të paraqiten nënzëra që ndajnë aktivet financiare sipas këtyre bazave të matjes. Ndarja sjell një nënzë që përfshin investimet në tituj kapitali dhe investimet në tituj borxhi të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes dhe një nënzë që përfshin investimet në tituj borxhi të matur me koston e amortizuar. Për shkak se investimet në tituj kapitali janë të ndryshëm nga investimet në tituj borxhi në atë që ekspozojnë njësinë ekonomike ndaj rreziqeve të ndryshme, njësia ekonomike do të vlerësojë nëse është e nevojshme ndarja e mëtejshme në pasqyrën e pozicionit financiar e aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në investime në tituj kapitali dhe investime në tituj borxhi, për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme. Nëse nuk nevojitet dhe nëse informacioni i rezultuar do të ishte material, njësia ekonomike do të duhet të japë informacion shpjegues në shënimet për investimet në tituj kapitali veçmas nga investimet në tituj borxhi. Gjithashtu, nëse për shembull investimet në tituj kapitali do të kishin karakteristika të tjera të ndryshme, njësia ekonomike do të duhet të ndajë më tej këto investime në tituj kapitali në shënimet shpjeguese, nëse informacioni i rezultuar do të ishte material.

Përshkrimi i zërave

B24 Paragrafi 43 kërkon që njësia ekonomike duhet të emërtojë dhe përshkruajë zërat e paraqitur ose të dhënë si informacion shpjegues në shënimet në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e zërit. Shpesh zëra të tillë do të jenë grupime zërash që vijnë nga transaksione individuale ose ngjarje të tjera dhe mund të ndryshojnë nëse janë grupime të zërave për të cilët informacioni është material dhe të zërave për të cilët informacioni është jomaterial. Veçanërisht, qoftë në pasqyrat financiare kryesore ose në shënimet shpjeguese:

(a) një zë për të cilin informacioni është material mund të grupohet me zëra të tjerë për të cilët informacioni është gjithashtu material—njësia ekonomike mund të bëjë një grupim të tillë për të përmbledhur informacionin, por gjithashtu do të duhet të japë informacion shpjegues për secilin zë;

(b) një zë për të cilin informacioni është material mund të grupohet me zëra për të cilët informacioni nuk është material—njësia ekonomike do të duhet të japë informacion mbi zërat e veçantë vetëm nëse informacioni jo material fsheh informacionin material; ose

(c) një zë për të cilin informacioni nuk është material mund të grupohet me zëra të tjerë për të cilët informacioni është gjithashtu jomaterial—njësia ekonomike mund të bëjë një grupim të tillë për të plotësuar një listë zërash dhe nuk i kërkohet të japë informacion shpjegues mbi zërat e veçantë, objekt të paragrafit B26(b).

B25 Njësia ekonomike do të emërtojë zërat e paraqitur ose të shpjeguar në shënime si 'të tjerë' vetëm nëse nuk mund të gjejë një emërtim më informues. Shembuj sesi një njësi ekonomike mund të gjejë një emërtim më të mirë janë:

(a) gjetja e një emërtimi që përshkruan zërin për të cilin informacioni është material, nëse një zë për të cilin informacioni është material grupohet me zëra për të cilët informacioni nuk është material; dhe

(b) nëse zërat për të cilët informacioni nuk është material grupohen:

(i) grupimi i zërave që kanë karakteristika të ngjashme dhe përshkrimi i tyre në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e ngjashme; ose

(ii) grupimi i zërave me zëra të tjerë që nuk kanë karakteristika të ngjashme dhe përshkrimi i tyre në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e ndryshme të zërave.

B26 Nëse njësia ekonomike nuk mund të gjejë një emërtim më informues se 'të tjerë':

(a) për çdo grupim—njësia ekonomike duhet të përdorë emërtimin që përshkruan zërin e grupuar në mënyrën më të saktë të mundshme, për shembull, 'shpenzime të tjera të shfrytëzimit' ose 'shpenzime të tjera financiare'.

(b) për grupin që përfshin vetëm zërat për të cilët informacioni nuk është material—njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse shuma e grupuar është mjaftueshëm e madhe dhe përdoruesit e pasqyrave financiare me të drejtë mund të pyesin nëse në të përfshihen zëra për të cilët informacioni do të ishte material. Nëse është kështu, informacioni që i përgjigjet asaj pyetjeje është informacion material. Për pasojë, në raste të tilla, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues të mëtejshëm mbi shumën—për shembull:

(i) një shpjegim që në shumë nuk përfshihen zëra për të cilët informacioni do të ishte material; ose

(ii) një shpjegim që shuma përfshin zëra të ndryshëm për të cilët informacioni nuk do të ishte material, me një sqarim të natyrës dhe shumës së zërit më të madh.

Kompensimi

B27 Paragrafi 44 nuk lejon që një njësi ekonomike të kompensojë aktivet dhe detyrimet apo të ardhurat dhe shpenzimet me përjashtim të rastit kur kjo gjë kërkohet ose lejohet nga një Standard i Kontabilitetit SNRF. Për shembull, SNRF 15 *Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët* kërkon që njësia ekonomike të matë të ardhurat nga kontratat me klientët në masën e shumës për të cilën njësia ekonomike pret që të ketë të drejtë në këmbim për transferimin e mallrave ose shërbimeve të premtuara. Shuma e të ardhurave të njohura reflekton çdo skonto dhe zbritje tregtare që lejon njësia ekonomike. Nga ana tjetër, njësia ekonomike mund të ndërmarrë, gjatë aktiviteteve të saj të zakonshme, transaksione të tjera të cilat nuk gjenerojnë të ardhura por janë rastësore për aktivitetet kryesore që gjenerojnë të ardhura. Njësia ekonomike do të paraqesë në pasqyrat financiare kryesore ose japë informacion shpjegues në shënime rezultatet e transaksioneve të tilla, nëse kjo paraqitje ose dhënie informacionesh shpjeguese reflekton thelbin e transaksionit ose të një ngjarjeje tjetër, duke zbritur nga të ardhurat shpenzimet përkatëse që lidhen me të njëjtin transaksion. Për shembull:

(a) njësia ekonomike paraqet në pasqyrat financiare kryesore ose jep informacion shpjegues në shënime, fitimet neto dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata, duke zbritur nga madhësia e shumës për nxjerrjen jashtë përdorimit, vlerën kontabël neto të aktivit dhe shpenzimet përkatëse të shitjes; dhe

(b) njësia ekonomike mund pakësojë shpenzimet lidhur me një provizion të njohur në përputhje me SNK 37 dhe të rimbursuar sipas një marrëveshjeje kontraktuale me një palë të tretë (për shembull një marrëveshje garancie me furnitorin) kundrejt rimbursimit përkatës.

B28 Përveç kësaj, njësia ekonomike paraqet mbi bazë neto, fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup transaksionesh të ngjashme— për shembull, fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit ose fitimet dhe humbjet nga instrumentet financiarë të mbajtur për tregtim që janë përfshirë në të njëjtën kategori të pasqyrës (pasqyrave) të performancës financiare në zbatim të paragrafëve 47–68. Megjithatë, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për fitime ose humbje të tilla veçmas në shënimet shpjeguese nëse kjo siguron informacion material.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Pasqyra e fitimit ose humbjes

Kategoritë në pasqyrën e fitimit ose humbjes

B29 Paragrafi 47 kërkon që një njësi ekonomike të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet e përfshira në pasqyrën e fitimit ose humbjes në një nga pesë kategoritë. Kategoria e shfrytëzimit përfshin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e pasqyrës së fitimit ose humbjes që nuk janë klasifikuar në kategoritë e tjera (shih paragrafin 52). Të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e operacioneve jo të vijueshme duke zbatuar paragrafin 68 nuk janë objekt i kërkesave për klasifikimin e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve në kategoritë e renditura në paragrafët 47(a)–(d). Të ardhurat dhe shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e tatimeve mbi të ardhurat, duke zbatuar paragrafin 67, nuk janë objekt i kërkesave për klasifikimin e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve në kategoritë e renditura në paragrafët 47(a)–(c).

Vlerësimi i aktiviteteve kryesore të specifikuara të biznesit

B30 Paragrafi 49 kërkon që njësia ekonomike të vlerësojë nëse investon në aktive apo siguron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi. Njësia ekonomike mund të ketë më shumë se një aktivitet kryesor biznesi. Për shembull, njësia ekonomike që prodhon një produkt dhe ofron financim tek klientët mund të përcaktojë sesi aktiviteti prodhues edhe aktiviteti i financimit të klientëve janë aktivitete kryesore biznesi. Për të klasifikuar të ardhurat dhe shpenzimet në kategoritë e shfrytëzimit, investuese dhe financiare siç kërkohet nga ky Standard, njësia ekonomike duhet vetëm të përcaktojë nëse njëri apo të dy, investimi në aktive dhe ofrimi i financimit për klientët, janë aktivitete kryesore të biznesit.

B31 Shembuj të njësive ekonomike që mund të investojnë në aktive si aktivitet kryesor biznesi përfshijnë:

(a) njësitë ekonomike investuese sipas përcaktimit në SNRF 10 *Pasqyra Financiare të Konsoliduara*;

(b) shoqëritë e aktiveve afatgjata materiale të investuara; dhe

(c) siguruesit.

B32 Shembuj të njësive ekonomike që mund të ofrojnë financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi përfshijnë:

(a) bankat dhe institucionet e tjera të huadhënies;

(b) njësitë ekonomike që ofrojnë financim për klientët për t'u mundësuar klientëve blerjen e produkteve të saj; dhe

(c) qiradhënës që ofrojnë financim për klientët në qira financiare.

B33 Nëse investimi në aktive ose ofrimi i financimit për klientët është një aktivitet kryesor biznesi i njësisë ekonomike është një fakt dhe jo thjesht një pohim. Njësia ekonomike duhet të përdorë gjykimin për të vlerësuar nëse investimi në aktive apo ofrimi i financimit për klientët është një aktivitet kryesor biznesi dhe ky vlerësim duhet të mbështetet në evidencë.

B34 Në përgjithësi, investimi në aktive ose ofrimi i financimit për klientët ka mundësi të jetë aktivitet kryesor biznesi i një njësie ekonomike nëse njësia përdor një lloj të caktuar nënshume si një tregues të rëndësishëm të performancës së shfrytëzimit. Një lloj i caktuar nënshume është një nënshumë e ngjashme me fitimin bruto (shih paragrafin B123) që përfshin të ardhurat dhe shpenzimet që do të klasifikoheshin në kategoritë investuese ose financiare nëse investimi në aktive ose ofrimi i financimit për klientët nuk do të ishin aktivitete kryesore biznesi.

B35 Evidenca që nënshuma të ngjashme me fitimin bruto të përshkruar në paragrafin B123 janë tregues të rëndësishëm të performancës së shfrytëzimit përfshijnë përdorimin e nënshumave të tilla për:

(a) të shpjeguar performancën e shfrytëzimit nga jashtë; ose

(b) të vlerësuar ose monitoruar performancën e shfrytëzimit nga brenda.

B36 Informacioni mbi segmentet mund të ofrojë evidencë se investimi në aktive ose ofrimi i financimit për klientët është aktivitet kryesor biznesi nëse njësia ekonomike zbaton SNRF 8 *Segmente Shfrytëzimi*. Në mënyrë specifike:

(a) nëse një segment raportues përfshin një aktivitet të vetëm biznesi, kjo tregon se performanca e segmentit raportues është një tregues i rëndësishëm i performancës së shfrytëzimit të njësisë ekonomike dhe se aktiviteti i biznesit i segmentit raportues është aktiviteti kryesor i biznesit i njësisë ekonomike; dhe

(b) nëse një segment shfrytëzimi përfshin një aktivitet të vetëm biznesi, kjo tregon se aktiviteti i biznesit mund të jetë aktiviteti kryesor i biznesit i njësisë ekonomike nëse performanca e segmentit të shfrytëzimit është një tregues i rëndësishëm i performancës së shfrytëzimit të njësisë ekonomike, siç përshkruhet në paragrafin B34.

B37 Njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse investimi në aktive apo ofrimi i financimit për klientët është një aktivitet kryesor biznesi për njësinë ekonomike raportuese si një e tërë. Për pasojë, vlerësimi nëse investimi në aktive ose ofrimi i financimit për klientët është një aktivitet kryesor biznesi nga një njësi ekonomike raportuese që është një grup i konsoliduar dhe një njësi ekonomike raportuese që është një filial në një grup të konsoliduar, mund të japë rezultate të ndryshme.

B38 Njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse investon si aktivitet kryesor biznesi në pjesëmarrje, sipërmarrje të përbashkëta dhe filiale jo të konsoliduara që nuk kontabilizohen sipas metodës së kapitalit neto (shih paragrafët B43(b)–(c) dhe B44(b)–(c)) për aktive individuale ose duke përdorur grupe aktivesh me karakteristika të përbashkëta. Nëse një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare individuale siç specifikohet në SNK 27 *Pasqyrat Financiare Individuale* dhe kryen vlerësimin për grupe aktivesh, njësia ekonomike duhet të përdorë grupet e aktiveve që janë në përputhje me kategoritë e përdorura për të përcaktuar bazën e tyre të matjes kur zbatohet paragrafi 10 i SNK 27. Njësia ekonomike nuk ka nevojë të vlerësojë nëse investon si aktivitet kryesor biznesi në pjesëmarrje, sipërmarrje të përbashkëta dhe filiale jo të konsoliduara të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto (shih paragrafët B43(a) dhe B44(a)), sepse asaj i kërkohet që të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet nga këto investime në kategorinë investuese (shih paragrafin 55(a)).

B39 Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të vlerësojë nëse investon si aktivitet kryesor biznesi në mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (shih paragrafin 53(b)). Njësia ekonomike duhet të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet nga mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në kategorinë investuese përveçse kur zbatohen paragrafët 56(a) ose 56(b).

B40 Njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse investon si aktivitet kryesor biznesi në aktive të tjera që gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike (shih paragrafin 53(c)) duke vlerësuar një aktiv individual ose grupet e aktiveve me karakteristika të përbashkëta. Kur kryhet vlerësimi për grupe të aktiveve financiare, njësia ekonomike duhet të përdorë grupe të aktiveve financiare që janë në përputhje me klasat e aktiveve financiare të identifikuara nga njësia ekonomike kur zbaton paragrafin 6 të SNRF 7.

B41 Njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse investimi në aktive ose ofrimi i financimit për klientët është një aktivitet kryesor biznesi bazuar në faktet në atë kohë, kështu që një ndryshim në rezultatin e vlerësimit nuk ndryshon rezultatin e vlerësimeve të mëparshme. Për pasojë, njësia ekonomike klasifikon dhe paraqet të ardhurat dhe shpenzimet duke zbatuar ndryshimin në rezultatin e vlerësimit në perspektivë nga data e ndryshimit dhe nuk riklasifikon shumat e paraqitura para datës së ndryshimit. Paragrafi 51(c)(ii) kërkon që njësia ekonomike të japë informacion shpjegues mbi shumën dhe klasifikimin e zërave të të ardhurave dhe të shpenzimeve para dhe pas datës së ndryshimit në rezultatin e vlerësimit në periudhën aktuale dhe shumën dhe klasifikimin në periudhën paraardhëse për zërat për të cilët klasifikimi ka ndryshuar për shkak të rezultatit të ndryshuar të vlerësimit, me përjashtim të rastit kur kjo është praktikisht e pazbatueshme.

Shfrytëzimi

B42 Kërkesat në paragrafët 47–66 sjellin që njësia ekonomike do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivitetet e saj kryesore të biznesit në kategorinë e shfrytëzimit të pasqyrës së fitimit ose humbjes, me përjashtim të rastit kur të ardhura dhe shpenzime të tilla nga investimet kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto. Gjithashtu, kategoria e shfrytëzimit nuk kufizohet vetëm tek të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivitetet kryesore të biznesit të njësisë ekonomike. Ajo përfshin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që nuk klasifikohen nga njësia ekonomike në kategoritë e tjera në zbatim të paragrafëve 53–68, përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e ndryshueshme ose rastësore.

Investimi

Investime në filiale, sipërmarrje të përbashkëta dhe filiale jo të konsoliduara

B43 Paragrafët 53 dhe 55 paraqesin kërkesat për klasifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta. Këto investime përfshijnë:

(a) investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto në përputhje me paragrafin 16 të SNK 28 *Investimet në Pjesëmarrjet dhe në Sipërmarrjet e Përbashkëta* dhe paragrafin 10(c) të SNK 27;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta (ose një pjesë e tyre) që njësia ekonomike zgjedh t'i matë me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9 kur zbaton paragrafët 18–19 të SNK 28 dhe paragrafin 11 të SNK 27; dhe

(c) investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta që janë kontabilizuar me kosto kur zbatohet paragrafi 10(a) i SNK 27 ose në përputhje me SNRF 9 kur zbatohet paragrafi 10(b) i SNK 27.

B44 Gjithashtu, paragrafët 53 dhe 55 paraqesin kërkesat për klasifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga filialet e pakonsoliduara. Investimet në filialet jo të konsoliduara përfshijnë:

(a) investime në filiale në pasqyra financiare individuale të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto në përputhje me paragrafin 10(c) të SNK 27;

(b) investime në filiale të mbajtuara nga një njësi ekonomike investuese që janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 31 të SNRF 10 dhe paragrafin 11A të SNK 27; dhe

(c) investimet në filiale në pasqyra financiare individuale që janë kontabilizuar me kosto kur zbatohet paragrafi 10(a) i SNK 27 ose në përputhje me SNRF 9 kur zbatohet paragrafi 10(b) i SNK 27.

Aktivet që gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike

B45 Paragrafi 53(c) kërkon që njësia ekonomike të identifikojë aktivet që gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike. Kthimi mund të jetë pozitiv ose negativ.

B46 Aktivet që gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike në paragrafin 53(c) zakonisht përfshijnë:

(a) investimet në tituj borxhi ose të kapitalit neto; dhe

(b) aktivet afatgjata materiale të investuara dhe të drejtat e arkëtueshme të gjeneruara nga qiraja e këtyre aktiveve.

B47 Të ardhurat dhe shpenzimet e cilësuara në paragrafin 54 nga aktive të tilla zakonisht përfshijnë:

(a) interesin;

(b) dividendët;

(c) të ardhura nga qiraja;

(d) amortizimin;

(e) humbje nga zhvlerësimi dhe anulim të humbjeve nga zhvlerësimi;

(f) fitimet neto ose humbjet nga vlerësimi me vlerën e drejtë; dhe

(g) të ardhurat dhe shpenzimet nga çregjistrimi i aktivit, ose klasifikimi dhe rimatja e tij si i mbajtur për shitje (shih paragrafët B60–B64).

Aktivet që nuk gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike

B48 Aktivet që njësia ekonomike i përdor së bashku për të prodhuar ose ofruar mallra apo shërbime nuk gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike. Zakonisht aktive të tilla përfshijnë:

(a) aktivet afatgjata materiale;

(b) aktivet që vijnë nga prodhimi ose ofrimi i mallrave dhe shërbimeve për të cilët të ardhurat dhe shpenzimet janë klasifikuar në kategorinë e shfrytëzimit (për shembull, llogaritë e arkëtueshme për këto mallra apo shërbime); dhe

(c) çdo hua tek klienti, nëse njësia ekonomike ofron financim tek klientët si aktivitet kryesor biznesi.

B49 Të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivet e përshkruara në paragrafin B48 klasifikohen në kategorinë e shfrytëzimit—për shembull:

(a) të ardhurat për mallrat ose shërbimet e prodhuara apo të ofruara nga njësia ekonomike duke përdorur së bashku aktivet;

(b) të ardhurat nga interesi;

(c) zhvlerësimi dhe amortizimi;

(d) humbje nga zhvlerësimi dhe anulim të humbjeve nga zhvlerësimi;

(e) të ardhurat dhe shpenzimet nga çregjistrimi i aktivit, ose klasifikimi dhe rimatja e tij si i mbajtur për shitje (shih paragrafët B60–B64); dhe

(f) të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga një kombinim biznesi që përfshin aktive që do të sjellin të ardhura dhe shpenzime që do të klasifikoheshin në kategorinë e shfrytëzimit të tilla si fitime neto në një blerje me okazion dhe rimatjet e një shume të kushtëzuar.

Financimi

Detyrime që vijnë nga transaksione që përfshijnë vetëm marrjen e financimit

B50 Paragrafi 59(a) kërkon që njësia ekonomike të identifikojë detyrimet që vijnë nga transaksione që përfshijnë vetëm marrjen e financimit. Në transaksione të tilla, njësia ekonomike:

(a) merr financim në formën e mjeteve monetare, ose një shlyerje të një detyrimi financiar, ose merr instrumente të kapitalit neto të vetë njësisë ekonomike; dhe

(b) në një datë të mëvonshme do të kthejë në këmbim mjete monetare ose instrumente të kapitalit neto të saj.

B51 Detyrimet që vijnë nga transaksione që përfshijnë vetëm marrjen e financimit përfshijnë:

(a) një instrument borxhi që do të shlyhet në mjete monetare, i tillë si obligacione (pa garanci specifike), hua, dëftesa, obligacione dhe hua hipotekare—njësia ekonomike merr mjete monetare dhe do të kthejë në këmbim mjete monetare;

(b) një detyrim sipas një marrëveshjeje financimi furnizimi kur llogaritë e pagueshme për mallrat apo shërbimet janë çregjistruar—njësia ekonomike është liruar nga detyrimi financiar për mallrat apo shërbimet dhe do të kthejë në këmbim mjete monetare;

(c) një obligacion i cili do të shlyhet me lëvrimin e aksioneve të njësisë ekonomike—njësia ekonomike merr mjete monetare dhe do të kthejë në këmbim instrumente të kapitalit neto të saj; dhe

(d) një detyrim për njësinë ekonomike që të blejë instrumente të kapitalit neto të saj—njësia ekonomike merr instrumente të kapitalit neto të saj dhe do të kthejë në këmbim mjete monetare.

B52 Shembuj të të ardhurave dhe shpenzimeve nga detyrime të tilla që paragrafi 60 i kërkon një njësie ekonomike të klasifikojë në kategorinë financiare përfshijnë:

(a) shpenzimet e interesit (për shembull mbi instrumentet e emetuar të borxhit);

(b) fitimet dhe humbjet neto nga vlerësimi me vlerën e drejtë (për shembull mbi një detyrim të përcaktuar si me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes);

(c) dividendët në aksione të emetuara të klasifikuara si detyrime; dhe

(d) të ardhurat dhe shpenzimet nga çregjistrimi i detyrimit (shih paragrafin B61).

Detyrime që vijnë nga transaksione që nuk përfshijnë vetëm marrjen e financimit

B53 Paragrafi 59(b) kërkon që njësia ekonomike të identifikojë detyrimet që vijnë nga transaksione që nuk përfshijnë vetëm marrjen e financimit. Detyrime të tilla përfshijnë:

(a) llogari të pagueshme për mallrat ose shërbimet që do të shlyhen në mjete monetare—njësia ekonomike merr mallra ose shërbime, jo financim në formën e përshkruar në paragrafin B50(a);

(b) detyrimet e kontratës—njësia ekonomike do të kthejë mallrat dhe shërbimet, jo mjete monetare apo instrumente të kapitalit neto të saj siç përshkruhet në paragrafin B50(b);

(c) detyrimet për qira—njësia ekonomike merr një aktiv me të drejtë përdorimi, jo financim në formën e përshkruar në paragrafin B50(a);

(d) detyrimet për përfitime të përcaktuara nga pensioni—njësia ekonomike merr shërbimin e punonjësit, jo financim në formën e përshkruar në paragrafin B50(a);

(e) provizionet për nxjerrje nga përdorimi ose restaurim aktivi—njësia ekonomike merr një aktiv që nuk është financim në formën e përshkruar në paragrafin B50(a); dhe

 © Fondacioni i SNRF-ve

(f) provizion për konflikte gjyqësore—njësia ekonomike nuk merr financim siç përshkruhet në paragrafin B50(a).

B54 Shembuj të të ardhurave dhe shpenzimeve nga detyrime të tilla që paragrafi 61 i kërkon një njësie ekonomike të klasifikojë në kategorinë financiare përfshijnë:

(a) shpenzime interesi mbi llogari të pagueshme që vijnë nga blerja e mallrave apo shërbimeve, duke zbatuar SNRF 9;

(b) shpenzime interesi nga detyrimi i kontratës me përbërës të rëndësishëm financimi siç specifikohet në SNRF 15;

(c) shpenzime interesi mbi detyrimin e qirasë, duke zbatuar SNRF 16;

(d) shpenzime (të ardhura) neto interesi mbi një detyrim (aktiv) neto për përfitime të përcaktuara, duke zbatuar SNK 19; dhe

(e) rritjen e shumave të skontuara gjatë periudhës nga një provizion që vjen me kalimin e kohës dhe efekti i ndonjë ndryshimi në normat e skontimit të provizioneve, duke zbatuar SNK 37.

B55 Shembuj të të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga transaksionet që nuk përfshijnë vetëm marrjen e financimit por që nuk janë objekt i paragrafit 61 dhe për rrjedhojë klasifikohen në kategorinë e shfrytëzimit, përfshijnë:

(a) shpenzimet e njohura për konsumin e mallrave apo shërbimeve të blera të përshkruara në paragrafin B54(a);

(b) kosto shërbimi aktuale dhe të shkuara që vijnë nga një skemë e përfitimeve të përcaktuara, duke zbatuar SNK 19; dhe

(c) rimatjet e vlerës së drejtë të një detyrimi për shumën e kushtëzuar në një kombinim biznesi të njohur duke zbatuar SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*.

Klasifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve nga kontratat hibride që përmbajnë si bazë një detyrim

B56 Klasifikimi nga njësia ekonomike i të ardhurave dhe shpenzimeve nga një kontratë hibride me një bazë që është detyrim, varet nëse derivativi i përfshirë është i veçuar nga kontrata bazë. Nëse derivativi i përfshirë:

(a) është i veçuar nga detyrimi bazë:

(i) për detyrimin bazë të veçuar —njësia ekonomike zbaton kërkesat për të ardhurat dhe shpenzimet nga detyrimet, siç specifikohet në paragrafët 52, 59–61, 64(b) dhe 65–66; dhe

(ii) për derivativin e përfshirë të veçuar—njësia ekonomike zbaton kërkesat për të ardhurat dhe shpenzimet nga derivativët, siç specifikohet në paragrafët B70–B76;

(b) nuk është i veçuar nga detyrimi bazë dhe nëse kontrata hibride vjen nga një transaksion që përfshin vetëm marrjen e financimit—njësia ekonomike zbaton kërkesat për detyrimet që vijnë nga transaksione të tilla, siç specifikohet në paragrafët 52, 60 dhe 65–66;

(c) nuk është i veçuar nga detyrimi bazë dhe nëse kontrata hibride nuk vjen nga një transaksion që përfshin vetëm marrjen e financimit:

(i) nëse detyrimi bazë është një detyrim financiar brenda objektit të SNRF 9 që matet me koston e amortizuar—njësia ekonomike klasifikon në kategorinë financiare të ardhurat dhe shpenzimet e specifikuara në paragrafin 60 nga kontrata pas njohjes fillestare (në vend të të ardhurave dhe shpenzimeve të specifikuara në paragrafin 61) (shih paragrafin B59);

(ii) nëse kontrata hibride është një kontrate sigurimi brenda objektit të SNRF 17—njësia ekonomike zbaton kërkesat në paragrafët 52 dhe 64(b); dhe

(iii) ndryshe—njësia ekonomike zbaton kërkesat për të ardhurat dhe shpenzimet nga detyrimet që vijnë nga transaksione të tilla, siç specifikohet në paragrafët 52 dhe 61.

B57 Një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafët B56(b) dhe B56(c) për të gjitha kontratat hibride që përmbajnë një detyrim bazë për të cilin derivativi i përfshirë nuk është i veçuar, pavarësisht nëse derivativi i përfshirë nuk është veçuar nga njësia ekonomike duke zbatuar paragrafin 4.3.3 të SNRF 9 ose duke zbatuar paragrafin 4.3.5 të SNRF 9.

Detyrimet që vijnë nga kontratat e investimit të emetuara me tipare pjesëmarrjeje

B58 Paragrafi 64(a) paraqet kërkesat për të ardhurat dhe shpenzimet nga detyrimet që vijnë nga kontratat e investimit të emetuara me tipare pjesëmarrjeje të njohura duke zbatuar SNRF 9. Shembuj të kontratave të tilla të investimit janë:

(a) një kontratë investimi me tipare pjesëmarrjeje e emetuar nga një sigurues që nuk plotëson përkufizimin në SNRF 17 të një kontrate investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë; dhe

(b) një kontratë investimi me tipare të pjesëmarrjes të emetuar nga njësi ekonomike investuese.

Të ardhura dhe shpenzime të klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit nga një njësi ekonomike që ofron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi

B59 Paragrafi 65 kërkon që një njësi ekonomike, e cila ofron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi, të klasifikojë në kategorinë e shfrytëzimit të ardhura dhe shpenzime nga disa ose të gjitha detyrimet e lindura nga transaksionet që përfshijnë vetëm marrjen e financimit. Njësia ekonomike do të zbatojë edhe kërkesat në atë paragraf për të ardhurat dhe shpenzimet nga një derivativ që lidhet me një transaksion që përfshin vetëm marrjen e financimit të cilësuar në paragrafin B73(a), por jo të ardhurat dhe shpenzimet nga një kontratë hibride të specifikuara në paragrafin B56(c)(i).

Çregjistrimi dhe ndryshimi i klasifikimit

Çregjistrimi i një aktivi ose detyrimi, ose klasifikimi dhe rimatja e një aktivi si i mbajtur për shitje

B60 Paragrafët B47(g) dhe B49(e) u referohen të ardhurave dhe shpenzimeve nga çregjistrimi i një aktivi ose klasifikimi i tij si i mbajtur për shitje. Njësia ekonomike do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet nga çregjistrimi, ose nga klasifikimi i tij si i mbajtur për shitje dhe çdo matje e mëpasshme si i mbajtur për shitje, në të njëjtën kategori siç ka klasifikuar të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivi menjëherë para çregjistrimit të tij. Për shembull, njësia ekonomike do të klasifikojë fitimet dhe humbjet neto:

(a) nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)—në kategorinë e shfrytëzimit;

(b) nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivit afatgjatë material të investuar që njësia ekonomike nuk e investon si aktivitet kryesor biznesi—në kategorinë investuese; dhe

(c) nga rimatja e një investimi në pjesëmarrje të kontabilizuar më parë sipas metodës së kapitalit neto në hapin e blerjes së një filiali—në kategorinë investuese.

B61 Njësia ekonomike do të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet nga çregjistrimi i një detyrimi duke zbatuar kërkesat në paragrafët 52 dhe 59–60. Për shembull, njësia ekonomike klasifikon të ardhurat dhe shpenzimet nga çregjistrimi i një detyrimi:

(a) në kategorinë financiare—nëse detyrimi vjen nga një transaksion që përfshin vetëm marrjen e financimit nga një njësi ekonomike që nuk ofron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi; dhe

(b) në kategorinë e shfrytëzimit—nëse si palë e një marrëveshjeje financimi furnizimi, njësia ekonomike çregjistron një llogari të pagueshme tek një furnitor dhe njeh një detyrim sipas asaj marrëveshjeje.

Ndryshimi në përdorimin e një aktivi

B62 Një transaksion ose një ngjarje tjetër mund të ndryshojë kategorinë në pasqyrën e fitimit ose humbjes në të cilën njësia ekonomike klasifikon të ardhurat dhe shpenzimet nga një aktiv, edhe pse aktivi nuk është çregjistruar. Në raste të tilla, njësia ekonomike klasifikon të ardhurat dhe shpenzimet nga transaksioni ose ngjarja tjetër në kategorinë në të cilën ajo klasifikon të ardhurat dhe shpenzimet nga aktivi menjëherë para transaksionit apo ngjarjes. Për shembull, njësia ekonomike do të klasifikojë në kategorinë e shfrytëzimit çdo të ardhur apo shpenzim të njohur në pasqyrën e fitimit ose humbjes nga transferimi i pasurisë nga objekt i SNK 16 tek aktivet afatgjata materiale të investuara objekt i SNK 40.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Grupet e aktiveve dhe të detyrimeve

B63 Paragrafët B60–B62 paraqesin kërkesat për të ardhurat dhe shpenzimet nga çregjistrimi, klasifikimi dhe matja e mëpasshme si i mbajtur për shitje, ose nga ndryshimi në përdorim i një aktivi ose i një detyrimi. Një transaksion ose një ngjarje tjetër mund të sjellë këto rezultate për një grup aktivesh (ose një grup të aktiveve dhe detyrimeve) që gjenerojnë të ardhura dhe shpenzime që një njësi ekonomike i ka klasifikuar në kategori të ndryshme menjëherë para transaksionit ose ngjarjes tjetër. Njësia ekonomike duhet të klasifikojë të ardhurat apo shpenzimet nga një transaksion i tillë ose ngjarje tjetër e tillë:

(a) në kategorinë investuese nëse, me përjashtim të aktiveve nga tatimi mbi të ardhurat, të gjitha aktivet në grup gjeneruan të ardhura dhe shpenzime që njësia ekonomike i ka klasifikuar në kategorinë investuese menjëherë para transaksionit ose ngjarjes tjetër; dhe

(b) në kategorinë e shfrytëzimit në të gjitha rastet e tjera.

B64 Për shembull njësia ekonomike klasifikon:

(a) në kategorinë e shfrytëzimit—fitimet dhe humbjet neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e një filiali të konsoliduar, nëse filiali përfshinte aktivet që gjeneruan të ardhura dhe shpenzime që njësia ekonomike i ka klasifikuar në kategorinë e shfrytëzimit menjëherë para nxjerrjes jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet neto përfshijnë riklasifikimin nga kapitali neto në fitim ose humbje të diferencave të kurseve të këmbimit të kërkuara nga paragrafi 48 i SNK 21.

(b) në kategorinë e shfrytëzimit—një humbje nga zhvlerësimi që vjen nga klasifikimi i nxjerrjes jashtë përdorimit të grupit të mbajtur për shitje nga njësia ekonomike në zbatim të SNRF 5, nëse nxjerrja jashtë përdorimit e grupit përfshinte aktivet që gjeneronin të ardhura dhe shpenzime që njësia ekonomike i ka klasifikuar në kategorinë e shfrytëzimit menjëherë para klasifikimit të tyre si të mbajtur për shitje.

(c) në kategorinë investuese—fitimet dhe humbjet neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e një filiali të konsoliduar, nëse vetëm aktivet e filialit ishin aktive afatgjata materiale të investuara që njësia ekonomike raportuese e konsoliduar nuk i investon si një aktivitet kryesor biznesi dhe aktivet përkatëse të tatimit mbi të ardhurat. Fitimet dhe humbjet përfshijnë riklasifikimin nga kapitali neto në fitim ose humbje të diferencave të kurseve të këmbimit të kërkuara nga paragrafi 48 i SNK 21.

Klasifikimi i diferencave nga kurset e këmbimit dhe i fitimit ose humbjes neto nga pozicioni monetar neto

B65 Për të zbatuar paragrafin 47, një njësi ekonomike duhet të klasifikojë diferencat nga këmbimi të përfshira në pasqyrën e fitimit ose humbjes duke zbatuar SNK 21 në të njëjtën kategori si të ardhurat dhe shpenzimet nga zërat që sjellin diferencat nga këmbimi, me përjashtim të rastit kur kjo do të kërkonte kosto apo përpjekje të papërshtatshme (shih paragrafin B68).

B66 Për shembull, njësia ekonomike klasifikon diferencat nga këmbimi në:

(a) një llogari të arkëtueshme të përshkruar në paragrafin B48(b) të emërtuar në monedhën e huaj, në të njëjtën kategori si të ardhurat dhe shpenzimet nga ai aktiv—që do të thotë, në kategorinë e shfrytëzimit; dhe

(b) një instrument borxhi që është detyrim i përshkruar në paragrafin B51(a) i emërtuar në monedhën e huaj, në të njëjtën kategori si të ardhurat dhe shpenzimet nga ai detyrim—që do të thotë në kategorinë financiare (me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike ofron financim për klientët si një aktivitet kryesor biznesi dhe klasifikon të ardhurat dhe shpenzimet nga detyrimi në kategorinë e shfrytëzimit në zbatim të paragrafit 65).

B67 Njësia ekonomike mund të klasifikojë në më shumë se një kategori të ardhurat dhe shpenzimet nga një transaksion që nuk përfshin vetëm marrje financimi. Për shembull, blerja e shërbimeve në një transaksion të emërtuar në një monedhë të huaj dhe të negociuar në kushte të zgjeruara kreditimi mund të sjellë një shpenzim për blerjen e shërbimeve të klasifikuar në kategorinë e shfrytëzimit (shih paragrafin B55(a)) dhe shpenzime interesi të klasifikuara në kategorinë financiare (shih paragrafin B54 (a)). Në situata të tilla, objekt i paragrafit B68, njësia ekonomike duhet të përdorë gjykimin e saj për të përcaktuar nëse diferencat nga këmbimi lidhen me shumën e klasifikuar në kategorinë financiare—dhe të klasifikohen në atë kategori—ose nëse ato lidhen me shumën e klasifikuar në një kategori tjetër—dhe të klasifikohen në atë kategori. Njësia ekonomike nuk duhet të shpërndajë mes kategorive diferencat e këmbimit që vijnë nga një detyrim i një transaksioni që nuk përfshin vetëm marrje financimi. Kur gjykon sesi duhet të klasifikojë diferencat nga këmbimi, njësia ekonomike nuk ka nevojë të klasifikojë në të njëjtën kategori diferencat nga

këmbimi nga të gjitha detyrimet e tilla. Megjithatë, njësia ekonomike duhet të klasifikojë në të njëjtën kategori diferencat nga këmbimi të detyrimeve të ngjashme.

B68 Nëse zbatimi i kërkesave të paragrafëve B65 dhe B67 do të përfshijë kosto apo përpjekje të papërshtatshme, njësia ekonomike duhet të klasifikojë këto diferenca nga këmbimi në kategorinë e shfrytëzimit. Njësia ekonomike duhet të vlerësojë nëse klasifikimi i diferencave nga këmbimi siç përshkruhet në paragrafët B65 dhe B67 përfshin kosto apo përpjekje të papërshtatshme për secilin zë që sjell diferenca nga këmbimi. Vlerësimi është specifik mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me secilin zë. Nëse të njëjtat fakte dhe rrethana lidhen me një numër zërash, njësia ekonomike mund të zbatojë të njëjtin vlerësim për secilin zë.

B69 Kur zbaton paragrafin 28 të SNK 29 *Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste*, një njësi ekonomike mund të paraqesë fitimin ose humbjen neto në pozicionin monetar neto me zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me pozicionin monetar neto, të tilla si të ardhura dhe shpenzime interesi dhe diferenca nga këmbimi. Nëse njësia ekonomike nuk paraqet fitimin ose humbjen neto në pozicionin monetar neto me të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura, ajo duhet të klasifikojë fitimin ose humbjen neto në kategorinë e shfrytëzimit.

Klasifikimi i fitimeve dhe humbjeve neto nga derivativët dhe instrumentet e përcaktuar të mbrojtjes

B70 Paragrafi 47 kërkon që një njësi ekonomike të klasifikojë të ardhurat dhe shpenzimet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kategori. Për të zbatuar paragrafin 47, njësia ekonomike duhet të klasifikojë fitimet ose humbjet neto të përfshira në pasqyrën e fitimit ose humbjes, nga një instrument financiar i përcaktuar si instrument mbrojtës në zbatim të SNRF 9 në të njëjtën kategori si të ardhurat dhe shpenzimet që ndikohen nga rreziqet që zakonisht menaxhon instrumenti financiar. Megjithatë, nëse për të bërë këtë do të duhet të bashkoheshin fitime dhe humbje neto, një njësi ekonomike duhet të klasifikojë fitime dhe humbje neto të tilla në kategorinë e shfrytëzimit (shih paragrafët B74–B75).

B71 Njësia ekonomike duhet të klasifikojë fitimet dhe humbjet neto nga një përbërës jo i përcaktuar i një instrumenti mbrojtës të përcaktuar në të njëjtën kategori si fitimet dhe humbjet neto nga përbërësi i përcaktuar. Njësia ekonomike duhet të klasifikojë pjesët jo efektive të fitimit apo humbjes neto në të njëjtën kategori si pjesët efektive.

B72 Gjithashtu, njësia ekonomike duhet të zbatojë kërkesat në paragrafin B70 për fitimet dhe humbjet neto nga një derivativ që nuk është i përcaktuar si instrument mbrojtës në zbatim të SNRF 9, por përdoret për të menaxhuar rreziqet e identifikuara. Megjithatë, nëse për të bërë këtë do të duhet të bashkohen fitime apo humbje neto (shih paragrafët B74–B75) ose të përfshihen kosto apo përpjekje të papërshtatshme, njësia ekonomike duhet të klasifikojë të gjitha fitimet dhe humbjet neto nga derivativi në kategorinë e shfrytëzimit.

B73 Njësia ekonomike do të klasifikojë fitimet dhe humbjet neto nga një derivativ që nuk përdoret për të menaxhuar rreziqet e identifikuara:

(a) në kategorinë financiare, nëse derivativi lidhet me një transaksion që përfshin vetëm marrjen e financimit (për shembull, blerja e një opsioni blerjeje që lejon njësinë ekonomike emetuese të këmbejë një shumë fikse në monedhë të huaj për një numër të caktuar të instrumenteve të kapitalit neto të njësisë ekonomike), me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike që ofron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi, i klasifikon fitimet dhe humbjet neto në kategorinë e shfrytëzimit duke zbatuar paragrafin B59; dhe

(b) në kategorinë e shfrytëzimit, nëse nuk plotësohen kushtet në (a).

B74 Paragrafët B70 dhe B72 ndalojnë bashkimin e fitimeve dhe humbjeve neto nga instrumentet financiarë të përcaktuar si instrumente mbrojtës dhe nga derivativët jo të përcaktuar si instrumente mbrojtës. Bashkimi i fitimeve dhe humbjeve mund të vijë nga situata në të cilat:

(a) njësia ekonomike përdor instrumente financiarë të tillë për të menaxhuar rreziqet nga një grup zërash me pozicione rreziku të kompensueshme (shih paragrafin 6.6.1 të SNRF 9 për kriteret që një grup zërash të jetë një zë i përshtatshëm i mbrojtur); dhe

(b) rreziqet e menaxhuara ndikojnë nënzërat në më shumë se një kategori të pasqyrës së fitimit ose humbjes.

B75 Për shembull, njësia ekonomike mund të përdorë derivativë për të menaxhuar si rrezikun neto nga monedha e huaj në të ardhurat (të klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit) dhe në shpenzimet e interesit (të klasifikuara në kategorinë financiare). Në raste të tilla, diferencat nga këmbimi në të ardhurat kompensohen nga diferencat nga këmbimi në shpenzimet e interesit dhe fitimet ose humbjet neto në derivativin. Megjithatë, njësia ekonomike klasifikon diferencat nga këmbimi në të ardhurat në një kategorie të ndryshme nga diferencat nga këmbimi në shpenzimet e interesit. Për të paraqitur fitimin ose humbjen neto

 © Fondacioni i SNRF-ve

nga derivativi në secilën kategori, njësia ekonomike do të duhet të paraqesë në secilën kategori një fitim ose humbje neto më të madhe sesa ajo e pësuar nga derivativi. Kur zbaton kërkesat në paragrafët B70–B73, njësia ekonomike nuk do të bashkojë fitimet ose humbjet neto në këtë mënyrë por do të klasifikojë çdo fitim ose humbje neto nga derivativi në kategorinë e shfrytëzimit.

B76 Kërkesat në paragrafët B70–B75 specifikojnë vetëm sesi duhet të klasifikohen të ardhurat dhe shpenzimet në kategoritë e pasqyrës së fitimit ose humbjes. Ato nuk përshkruajnë nënzërin (apo nënzërat) në të cilat do të përfshihen të ardhura dhe shpenzime të tilla, apo nuk zëvendësojnë kërkesat në Standardet e tjera të Kontabilitetit SNRF.

Zërat për t'u paraqitur në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose për t'u dhënë si informacion shpjegues në shënimet

B77 Një njësi ekonomike mund t'i kërkohet të paraqesë një nënzë të renditur në paragrafin 75, ose të specifikuar në një tjetër Standard të Kontabilitetit SNRF, në më shumë se një nga kategoritë e renditura në paragrafin 47. Për shembull, njësia ekonomike që nuk investon në aktive ose nuk ofron financim për klientët si aktivitet kryesor biznesi mund të duhet që të paraqesë nënzërin e specifikuar në paragrafin 75(b)(ii) të humbjes nga zhvlerësimi të përcaktuar në përputhje me Seksionin 5.5 të SNRF 9 në:

(a) kategorinë e të shfrytëzimit—nëse lidhet me të arkëtueshme për mallra dhe shërbime siç përshkruhet në paragrafin B48(b); dhe

(b) kategorinë investuese—nëse lidhet me aktive financiare që gjenerojnë një kthim individual dhe kryesisht të pavarur nga burimet e tjera të njësisë ekonomike siç përshkruhet në paragrafin B46.

B78 Paragrafët 24 dhe 41(c) kërkojnë që njësia ekonomike të paraqesë nënzëra shtesë në pasqyrën e fitimit ose humbjes nëse kjo është e nevojshme për të dhënë një përmbledhje të strukturuar të dobishme të të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë ekonomike. Njësia ekonomike përdor gjykimin për të bërë këtë përcaktim (përfshirë nëse është e nevojshme të ndajë nënzërat e renditur në paragrafin 75). Paragrafët 20 dhe 41(d) kërkojnë që njësia ekonomike të ndajë zërat për të dhënë informacion shpjegues material në shënimet. Njësia ekonomike përdor gjykimin për të bërë këtë përcaktim. Paragrafi 41 kërkon që njësia ekonomike të mbështesë gjykimet e saj në një vlerësim nëse zërat kanë karakteristika të përbashkëta (karakteristika të ngjashme) ose karakteristika jo të përbashkëta (karakteristika jo të ngjashme). Karakteristika të tilla përfshijnë:

(a) natyrën (shih paragrafin 80);

(b) funksionin (rolin) brenda aktiviteteve të biznesit të njësisë ekonomike (shih paragrafin 81);

(c) qëndrueshmërinë (përfshirë frekuencën e zërit të të ardhurave ose shpenzimeve apo nëse ai ndeshet rregullisht apo rrallë);

(d) bazat e matjes;

(e) matjen e pasigurisë ose rezultatin e pasigurisë (ose rreziqe të tjera të lidhura me një zë);

(f) madhësinë;

(g) zonën gjeografike ose mjedisin rregullator;

(h) efektet tatimore (për shembull, nëse shkallë (norma) të ndryshme tatimore zbatohen për zëra të të ardhurave ose shpenzimeve); dhe

(i) nëse të ardhurat ose shpenzimet vijnë nga njohja fillestare e një transaksioni ose ngjarje apo nga një ndryshim i mëpasshëm në vlerësim lidhur me transaksionin ose ngjarjen.

B79 Të ardhurat dhe shpenzimet që mund të kenë karakteristika të ndryshme të mjaftueshme dhe prandaj është e nevojshme paraqitja në pasqyrën e fitimit ose humbjes për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme ose është e nevojshme dhënia e informacionit shpjegues në shënime për të dhënë informacion material, përfshijnë:

(a) zhvlerësimet e inventarit, si dhe anulimet e zhvlerësimeve të tilla;

(b) humbjet nga zhvlerësimi për aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje) si dhe anulimet e humbjeve të tilla nga zhvlerësimi;

(c) të ardhurat dhe shpenzimet nga ristrukturimi i aktiviteteve të një njësie ekonomike dhe anulimet e çdo provizioni për ristrukturim;

(d) të ardhurat dhe shpenzimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje);

(e) të ardhurat dhe shpenzimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e investimeve;

(f) të ardhurat dhe shpenzimet nga zgjidhjet e konflikteve;

(g) anulimet e provizioneve; dhe

(h) të ardhurat dhe shpenzimet jo të rregullta, të papërfshira në (a)–(g).

Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese mbi shpenzimet e klasifikuara në kategorinë e shfrytëzimit

Përdorimi i karakteristikave të lidhura me natyrën dhe funksionin

B80 Kur përcakton sesi të përdorë karakteristikat e lidhura me natyrën dhe funksionin për të siguruar një përmbledhje të strukturuar sa më të dobishme, siç kërkohet nga paragrafi 78, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë:

(a) cilët nënzëra ofrojnë informacionin më të dobishëm mbi përbërësit apo nxitësit kryesorë të përfitueshmërisë së njësisë ekonomike. Për shembull, për një njësi ekonomike që shet me pakicë një përbërës ose nxitës kryesor i përfitueshmërisë mund të jetë kostoja e shitjeve. Paraqitja e një nënzëri mbi koston e shitjeve mund të sigurojë informacion të rëndësishëm mbi faktin nëse të ardhurat e gjeneruara nga shitja e mallrave mbulojnë ato që për shitësin me pakicë janë kostot kryesore direkte dhe me çfarë marzhi. Megjithatë, kostoja e shitjeve ka pak gjasa të ofrojë informacion përkatës mbi përbërësit ose nxitësit e rëndësishëm të përfitueshmërisë nëse lidhja mes të ardhurave dhe shpenzimeve është më pak e drejtpërdrejtë. Për shembull, për disa njësi ekonomike shërbimi, informacioni mbi shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës, të tilla si përfitimet e punonjësve, mund të jetë më i rëndësishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare sepse këto shpenzime janë nxitësit kryesorë të përfitueshmërisë.

(b) cilët nënzëra paraqesin më mirë mënyrën sesi menaxhohet biznesi dhe sesi drejtimi raporton brenda njësisë ekonomike. Për shembull, një njësi ekonomike prodhuese e drejtuar bazuar në funksionet kryesore mund të klasifikojë shpenzimet sipas funksionit për qëllime të raportimit të brendshëm. Anasjelltas, njësia ekonomike që ka vetëm një funksion dominues, të tillë si ofrimi i financimit për klientët, mund të përcaktojë që nënzërat që përfshijnë shpenzimet e klasifikuara sipas natyrës mund të sigurojnë informacion më të dobishëm për qëllime të raportimit të brendshëm.

(c) çfarë përfshin praktika standarde e industrisë. Nëse shpenzimet klasifikohen në të njëjtën mënyrë nga njësitë ekonomike në një industri, përdoruesit e pasqyrave financiare mund të krahasojnë më lehtë shpenzimet mes njësive ekonomike në të njëjtën industri.

(d) nëse shpërndarja e shpenzimeve të caktuara tek një funksion do të ishte e pavarur nga fakti që nënzërat e paraqitur nuk do të siguronin një paraqitje besnike të funksioneve. Në raste të tilla, njësia ekonomike do të klasifikojë këto shpenzime sipas natyrës.

B81 Në disa raste, një njësi ekonomike kur merr në konsideratë faktorët e paraqitur në paragrafin B80 mund të përcaktojë se klasifikimi dhe paraqitja e disa shpenzimeve sipas natyrës dhe e shpenzimeve të tjera sipas funksionit siguron përmbledhjen e strukturuar më të dobishme. Për shembull:

(a) faktorët në paragrafët B80(a)–(b) mund të tregojnë se klasifikimi dhe paraqitja e shpenzimeve sipas funksionit ofron përmbledhjen e strukturuar më të dobishme, me përjashtim të shpenzimeve të caktuara për të cilat shpërndarja sipas funksionit do të ishte arbitrare (shih paragrafin B80(d)); dhe

(b) një njësi ekonomike që ka dy tipe të ndryshme të aktiviteteve kryesore të biznesit mund të klasifikojë dhe paraqesë disa shpenzime sipas funksionit dhe shpenzime të tjera sipas natyrës për të siguruar informacion mbi nxitësit kryesorë të përfitueshmërisë së saj.

B82 Nëse njësia ekonomike klasifikon dhe paraqet disa shpenzime sipas natyrës dhe shpenzime të tjera sipas funksionit në pasqyrën e fitimit ose humbjes, ajo duhet të emërtojë nënzërat e rezultuar në një mënyrë që identifikon qartë se cilat shpenzime janë përfshirë në secilin nënzë. Për shembull, nëse njësia ekonomike përfshin disa përfitime të punonjësve në një nënzë sipas funksionit dhe përfitimet e tjera të punonjësve në nënzërin sipas natyrës, emërtimi i nënzërit sipas natyrës duhet të identifikojë qartë që nuk përfshin të gjitha përfitimet e punonjësve (për shembull, 'përfitimet e punonjësve të ndryshme nga ato të përfshira në koston e shitjeve').

B83 Kur zbaton paragrafin 30, njësia ekonomike duhet të klasifikojë dhe paraqesë shpenzimet në mënyrë të qëndrueshme nga njëra periudhë raportimi në tjetrën me përjashtim të rastit kur zbatohen paragrafët 30(a) ose 30(b). Për shembull, nëse njësia ekonomike paraqet zhvlerësimin e emrit të mirë si një nënzë sipas natyrës në një periudhë raportuese, ajo duhet të paraqesë edhe çdo zhvlerësim të ngjashëm të emrit të mirë

 © Fondacioni i SNRF-ve

si nënzë sipas natyrës në periudhat raportuese të mëpasshme, përveçse kur zbatohen paragrafët 30(a) ose 30(b). Nëse nuk ka zhvlerësim të ngjashëm të emrit të mirë në një periudhë të mëpasshme, fakti që ka një shpenzim zero në periudhën e mëpasshme nuk përbën ndryshim në klasifikim dhe paraqitje.

B84 Njësia ekonomike do të paraqesë shpenzimet sipas natyrës ose duke zbatuar paragrafin 83, do të japë informacione shpjeguese mbi disa shpenzime sipas natyrës. Nuk është e nevojshme që shumat e paraqitura ose të dhëna si informacion shpjegues të jenë shumat e njohura si shpenzim në atë periudhë. Ato mund të përfshijnë shumat që janë njohur si pjesë e vlerës kontabël (neto) të një aktivi. Nëse njësia ekonomike:

(a) paraqet shuma që nuk janë shuma të njohura si një shpenzim i periudhës, ajo do të paraqesë një nënzë shtesë për ndryshimin në vlerën kontabël (neto) të aktiveve të ndikuara. Për shembull, kur zbaton paragrafin 39 të SNK 2, njësia ekonomike mund të paraqesë një nënzë për ndryshimet në inventarët e produkteve të gatshme dhe të prodhimit në proces.

(b) jep si informacion shpjegues, kur zbaton paragrafin 83(b), shuma që nuk janë shuma të njohura si një shpenzim i periudhës, njësia ekonomike do të japë një shpjegim cilësor mbi këtë fakt duke identifikuar aktivet e përfshira.

Grupimi i shpenzimeve të shfrytëzimit

B85 Për të zbatuar paragrafin 78, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë se cili nivel i grupimit të shpenzimeve të shfrytëzimit siguron përmbledhjen e strukturuar më të dobishme. Për shembull, njësia ekonomike mund të ketë aktivitete administrative të ndryshme (të tilla si burimet njerëzore, teknologjia e informacionit, ligjore dhe kontabiliteti). Për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme, njësia ekonomike mund të bashkojë shpenzimet e shfrytëzimit që lidhen me këto aktivitete bazuar në karakteristikat e tyre të përbashkëta—të gjitha janë shpenzime për burimet e konsumuara në aktivitete administrative. Për pasojë, njësia ekonomike mund t'i paraqesë ato në një nënzë të emërtuar si 'shpenzime administrative'. Njësia ekonomike mund të ketë edhe shpenzime për burime të konsumuara në aktivitetet e shitjes. Këto shpenzime kanë një karakteristikë të dallueshme nga shpenzimet administrative—shpenzimet e shitjes vijnë nga burimet e konsumuara në aktivitetet e shitjes dhe shpenzimet administrative vijnë nga burimet e konsumuara në aktivitetet administrative. Këto karakteristika janë mjaftueshëm të ndryshme që ndarja—paraqitja në nënzëra të veçantë e shpenzimeve të shitjes dhe e shpenzimeve administrative—mund të jetë e nevojshme për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme të shpenzimeve të njësisë ekonomike.

Pasqyra që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse

Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse

B86 Disa Standarde të Kontabilitetit SNRF specifikojnë rrethanat kur një njësi ekonomike përfshin zëra të veçantë jashtë pasqyrës së fitimit ose humbjes në periudhën raportuese aktuale. SNK 8 trajton dy rrethana të tilla: korrigjimi i gabimeve dhe efekti i ndryshimeve në politikat kontabël. Standarde të tjera të Kontabilitetit SNRF kërkojnë ose lejojnë që njësia ekonomike të përjashtojë nga fitimi ose humbja përbërës të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që plotësojnë përkufizimin e të ardhurave ose shpenzimeve të *Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar* (shih paragrafin B87).

B87 Shtojca A përkufizon 'të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse'. Përbërësit e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

(a) ndryshimet në tepricën e rivlerësimit (shih SNK 16 dhe SNK 38);

(b) rimatjet e skemave me përfitime të përcaktuara (shih SNK 19);

(c) fitimet neto dhe humbjet që vijnë nga përkthimi i pasqyrave financiare të një operacioni të huaj (shih SNK 21);

(d) fitimet neto dhe humbjet nga investimet në instrumentet e kapitalit neto të përcaktuar me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9;

(e) fitimet neto dhe humbjet nga instrumentet financiare të matur me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 4.1.2A të SNRF 9;

(f) pjesën efektive të fitimeve neto dhe humbjeve në instrumentet mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare dhe fitimet neto dhe humbjet në instrumentet mbrojtës që mbrojnë investimet në instrumente të kapitalit neto të përcaktuar me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me paragrafin 5.7.5 të SNRF 9 (shih Kapitullin 6 të SNRF 9);

(g) për detyrime të veçanta të përcaktuara si me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë që i takon ndryshimeve në rrezikun e kredisë të detyrimit (shih paragrafin 5.7.7 të SNRF 9);

(h) ndryshimet e vlerës në kohë të opsioneve kur bëhet ndarja e vlerës së perceptuar dhe vlerës në kohë të një kontrate opsioni dhe përcaktimi si instrument mbrojtës vetëm i ndryshimeve në vlerën e perceptuar (shih Kapitullin 6 të SNRF 9);

(i) ndryshimet në vlerë të elementëve të së ardhmes (forward) të një kontrate të së ardhmes (forward) kur bëhet ndarja e elementit të së ardhmes dhe elementit të çastit të një kontrate të së ardhmes dhe përcaktimi si instrument mbrojtës vetëm i ndryshimeve në elementin e çastit, si dhe ndryshimet në vlerën e diferencialit të kurseve të këmbimit së monedhës së huaj të një instrumenti financiar kur ky është përjashtuar nga përcaktimi i këtij instrumenti financiar si një instrument mbrojtës (shih Kapitullin 6 të SNRF 9);

(j) të ardhurat dhe shpenzimet financiare të sigurimit nga kontratat e emetuara brenda objektit të SNRF 17 të përjashtuara nga fitimi ose humbja, kur totali i të ardhurave ose shpenzimeve financiare të sigurimit zbërthehet për të përfshirë në fitim ose humbje një shumë të përcaktuar nga shpërndarja sistematike duke zbatuar paragrafin 88(b) të SNRF 17, ose nga një shumë që eliminon mospërputhjet kontabël me të ardhurat ose shpenzimet financiare, që vijnë nga zërat bazë duke zbatuar paragrafin 89(b) të SNRF 17; dhe

(k) të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga kontratat e risigurimit të mbajtura e të përjashtuara nga fitimi ose humbja, kur totali i të ardhurave ose shpenzimeve financiare nga risigurimi zbërthehet për të përfshirë në rezultat një shumë të përcaktuar nga shpërndarja sistematike duke zbatuar paragrafin 88(b) të SNRF 17.

B88 Rregullime riklasifikimi vijnë, për shembull, nga nxjerrja jashtë përdorimit e një operacioni të kryer jashtë vendit (shih SNK 21) dhe kur disa flukse monetare të mbrojtura të parashikuara prekin fitimin ose humbjen (shih paragrafin 6.5.11(d) të SNRF 9 në lidhje me mbrojtjet e fluksit monetar).

B89 Paragrafi 90 kërkon që njësia ekonomike të paraqesë në pasqyrën që tregon të ardhurat gjithëpërfshirëse ose të japë informacion shpjegues në shënimet për rregullime të riklasifikimit që lidhen me përbërësit e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Rregullimet e riklasifikimit nuk rrjedhin nga ndryshimet në tepricën e rivlerësimit të njohur në përputhje me SNK 16 ose SNK 38 ose nga rimatjet e skemave të përfitimeve të përcaktuara të njohura në përputhje me SNK 19. Njësia ekonomike i njeh këta përbërës në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe nuk i riklasifikon në fitim ose humbje në periudhat raportuese pasuese. Njësia ekonomike mund të transferojë ndryshimet në tepricën e rivlerësimit tek fitimet e pashpërndara në periudhat pasuese me përdorimin e aktivit ose me çregjistrimin e tij (shih SNK 16 dhe SNK 38). Në përputhje me SNRF 9, nuk do të kemi rregullime të riklasifikimit nëse një mbrojtje e flukseve monetare ose trajtimi i vlerës në kohë të një opsioni (ose elementit të së ardhmes në një kontratë të së ardhmes (forward) ose diferencialit të kurseve të këmbimit së një monedhe të huaj në një instrument financiar) rezultojnë në shuma që njësia ekonomike i heq prej rezervës së fluksit monetar ose prej një përbërësi të veçantë të kapitalit neto, përkatësisht, si dhe i përfshin direkt në koston fillestare ose në ndonjë vlerë kontabël (neto) tjetër të një aktivi ose detyrimi. Njësia ekonomike i transferon këto shuma drejtpërdrejt tek aktivet ose detyrimet.

Pasqyra e pozicionit financiar

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata

B90 Kur zbaton paragrafin 96, nëse njësia ekonomike furnizon mallra ose shërbime brenda një cikli shfrytëzimi qartësisht të identifikueshëm, klasifikimi veçmas i aktiveve e detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar siguron informacion të dobishëm duke dalluar aktivet neto që qarkullojnë në mënyrë të vazhdueshme si kapital punues nga ato të përdorura në operacionet afatgjata të njësisë ekonomike. Një klasifikim i tillë thekson gjithashtu aktivet që njësia ekonomike pret të realizojë brenda ciklit aktual të shfrytëzimit dhe detyrimet që duhen shlyer brenda së njëjtës periudhë.

B91 Për disa njësi, të tilla si institucionet financiare, paraqitja e aktiveve dhe detyrimeve në rendin rritës ose zbritës të likuiditetit siguron një përmbledhje të strukturuar më të dobishme se një paraqitje afatshkurtër/afatgjatë, pasi njësia ekonomike nuk ofron mallra ose shërbime brenda një cikli shfrytëzimi qartësisht të identifikueshëm.

B92 Gjatë zbatimit të paragrafit 96, njësia ekonomike lejohet të paraqesë disa aktive dhe detyrime të saj duke përdorur klasifikimin afatshkurtër/afatgjatë dhe të tjerët sipas kriterit të likuiditetit kur kjo siguron një paraqitje të strukturuar më të dobishme. Nevoja për paraqitje me bazë të përzier mund të lindë nëse njësia ekonomike kryen operacione të ndryshme.

 © Fondacioni i SNRF-ve

B93 Informacioni lidhur me datat e pritshme të realizimit të aktiveve dhe detyrimeve është i dobishëm në vlerësimin e likuiditetit dhe aftësisë paguese të njësisë ekonomike. SNRF 7 kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese për datat e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare. Aktivet financiare përfshijnë llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme. Detyrimet financiare përfshijnë detyrimet tregtare dhe llogari të pagueshme të tjera. Informacioni lidhur me datën e pritshme të rikuperimit të aktiveve jomonetare si inventarët, si dhe datën e pritshme të shlyerjes për detyrimet si provizionet, është gjithashtu i dobishëm pavarësisht nëse aktivet dhe detyrimet janë apo jo të klasifikuara si afatshkurtra ose afatgjata. Për shembull, njësia ekonomike jep informacion shpjegues për shumën e inventarëve që pritet të rikuperohet përtej 12 muajve pas periudhës së raportimit.

Aktivet afatshkurtra

B94 Paragrafi 100 kërkon që një njësi ekonomike të klasifikojë si afatgjata të gjitha aktivet që nuk klasifikohen si afatshkurtër. Ky standard përdor termin 'afatgjatë' për të përfshirë aktivet e prekshme (materiale), të paprekshme (jomateriale) dhe financiare me natyrë afatgjatë. Ai nuk ndalon përdorimin e përshkrimeve alternative për sa kohë që kuptimi i tyre është i qartë.

B95 Cikli i shfrytëzimit i njësisë ekonomike është koha mes blerjes së aktiveve për përpunim dhe realizimin e tyre në mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare. Nëse cikli normal i shfrytëzimit i njësisë ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, supozohet se ai zgjat 12 muaj. Aktivet afatshkurtra përfshijnë aktive (si inventarët dhe llogari të arkëtueshme tregtare) që shiten, konsumohen ose realizohen si pjesë e ciklit normal të shfrytëzimit edhe kur nuk pritet që ato të realizohen brenda 12 muajve pas periudhës raportuese. Aktivet afatshkurtra përfshijnë edhe aktivet e mbajtura kryesisht për qëllime tregtare (shembuj përfshijnë disa aktive financiare që plotësojnë përkufizimin në SNRF 9 e të mbajturave për tregtim) dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve afatgjata financiare.

Detyrimet afatshkurtra

Cikël normal shfrytëzimi (shih paragrafin 101(a))

B96 Disa detyrime afatshkurtra, si p.sh. llogaritë e pagueshme tregtare dhe disa detyrime të konstatuara për punonjësit dhe kosto të tjera të shfrytëzimit, janë pjesë e kapitalit punues të përdorur në ciklin normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike. Njësia ekonomike i klasifikon zëra të tillë si detyrime afatshkurtra edhe pse mund të duhet të shlyhen përtej 12 muajve nga periudha e raportimit. Për klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike zbatohet i njëjti cikël normal shfrytëzimi. Nëse cikli normal i shfrytëzimit i njësisë ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, supozohet se ai zgjat 12 muaj.

Mbajtur kryesisht për tregtim (shih paragrafin 101(b)) ose duhet të shlyhet brenda 12 muajve (shih paragrafin 101(c))

B97 Detyrimet e tjera afatshkurtra nuk janë shlyer gjatë ciklit normal të shfrytëzimit, por që duhet të shlyhen brenda 12 muajve nga periudha e raportimit ose mbahen kryesisht për qëllime tregtare. Shembuj janë disa detyrime financiare që plotësojnë përkufizimin si të mbajtura për tregtim në SNRF 9, overdraftet (llogaritë e zbuluara) bankare dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve afatgjata financiare, dividendët e pagueshëm, tatimet mbi të ardhurat dhe të pagueshme të tjera jo tregtare. Detyrimet financiare që sigurojnë financim mbi një bazë afatgjatë (d.m.th. nuk janë pjesë e kapitalit punues të përdorur gjatë ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike) dhe që nuk kërkohet të shlyhen brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit janë detyrime afatgjata, objekt i paragrafëve B99–B103.

B98 Njësia ekonomike klasifikon detyrimet e saj financiare si afatshkurtra kur ato kërkohen për t'u shlyer brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit edhe nëse:

(a) afati fillestar ishte për një periudhë më të gjatë se 12 muaj; dhe

(b) një marrëveshje për rifinancimin ose riskedulimin e pagesave në baza afatgjata përfundon pas periudhës së raportimit dhe para se të autorizohet publikimi i pasqyrave financiare.

E drejta për ta shtyrë shlyerjen për të paktën 12 muaj (paragrafi 101(d))

B99 E drejta e një njësie ekonomike për ta shtyrë shlyerjen e një detyrimi për të paktën 12 muaj pas periudhës raportuese duhet të jetë thelbësore dhe duhet të ekzistojë në fund të periudhës së raportimit, siç ilustrohet në paragrafët B100–B103.

B100 E drejta e një njësie ekonomike për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi që vjen nga një marrëveshje huaje për të paktën 12 muaj pas periudhës së raportimit mund të jetë subjekt i plotësimit të kushteve nga ana e njësisë ekonomike të cilësuara në atë marrëveshje huaje (referuar si 'premtim kufizues' këtu e në vijim). Me qëllim zbatimin e paragrafit 101(d), premtime kufizuese të tilla:

(a) ndikojnë nëse ajo e drejtë ekziston në fund të periudhës së raportimit —siç ilustrohet në paragrafët B102–B103—nëse njësisë ekonomike i kërkohet të plotësojë premtimin kufizues në fund të periudhës së raportimit apo më parë. Një premtim kufizues i tillë ndikon nëse e drejta ekziston në fund të periudhës së raportimit edhe nëse pajtueshmëria me premtimin kufizues vlerësohet vetëm pas periudhës së raportimit (për shembull, një premtim kufizues i bazuar në pozicionin financiar të njësisë ekonomike në fund të periudhës së raportimit, por i vlerësuar për pajtueshmëri vetëm pas periudhës së raportimit).

(b) nuk ndikojnë nëse ajo e drejtë ekziston në fund të periudhës së raportimit nëse njësia ekonomike duhet të plotësojë premtimin kufizues vetëm pas periudhës së raportimit (për shembull, një premtim kufizues i bazuar në pozicionin financiar të njësisë ekonomike gjashtë muaj pas fundit të periudhës së raportimit).

B101 Nëse njësia ekonomike ka të drejtë, në fund të periudhës së raportimit, që të shtyjë një detyrim për të paktën 12 muaj pas periudhës së raportimit për një hua ekzistuese, ajo e klasifikon detyrimin si afatgjatë edhe nëse ndryshe do t'i duhej ta shlyejë brenda një periudhe më të shkurtër. Nëse njësia ekonomike nuk e ka një të drejtë të tillë, mundësia e rifinancimit nuk merret në konsideratë dhe detyrimi klasifikohet si afatshkurtër.

B102 Nëse njësia ekonomike shkel një premtim kufizues lidhur me një marrëveshje huaje afatgjatë në ose përpara fundit të periudhës së raportimit, me efekte që detyrimi bëhet i pagueshëm në të parë, detyrimi klasifikohet si afatshkurtër edhe nëse huadhënësi ka rënë dakord pas periudhës së raportimit dhe para autorizimit për publikimin e pasqyrave financiare, të mos kërkojë shlyerjen e huasë si pasojë e shkeljes. Njësia ekonomike e klasifikon detyrimin si afatshkurtër, sepse në fund të periudhës së raportimit ajo nuk ka të drejtë të shtyjë shlyerjen e tij për të paktën 12 muaj pas asaj date.

B103 Megjithatë, njësia ekonomike e klasifikon detyrimin si afatgjatë nëse huadhënësi ka rënë dakord që në fund të periudhës së raportimit të ofrojë një periudhë faljeje, e cila përfundon të paktën 12 muaj pas periudhës së raportimit dhe brenda të cilës njësia ekonomike mund të korrigjojë shkeljen, si dhe gjatë së cilës huadhënësi nuk mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme.

B104 Klasifikimi i një detyrimi nuk ndikohet nga mundësia që njësia ekonomike do të ushtrojë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas periudhës së raportimit. Nëse një detyrim plotëson kriteret në paragrafët 101–102 për t'u klasifikuar si afatgjatë, ai klasifikohet si afatgjatë edhe nëse drejtimi synon ose pret që njësia ekonomike ta shlyejë detyrimin brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit, ose edhe nëse njësia ekonomike e shlyen detyrimin pas periudhës së raportimit por para datës së autorizimit për publikim të pasqyrave financiare. Megjithatë, në të dy rrethanat, njësia ekonomike mund të ketë nevojë të japë informacion shpjegues mbi kohën e shlyerjes për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë ndikimin e detyrimit në pozicionin financiar të njësisë ekonomike (shih paragrafët 6C(c) të SNK 8 dhe B105(d)).

B105 Nëse ngjarjet vijuese ndodhin ndërmjet fundit të periudhës së raportimit dhe datës së autorizimit për publikim të pasqyrave financiare, për këto ngjarje jepet informacion shpjegues si ngjarje jorregulluese në përputhje me SNK 10 *Ngjarje pas datës së Periudhës së Raportimit*:

(a) rifinancimi mbi një bazë afatgjatë i një detyrimi të klasifikuar si afatshkurtër (shih paragrafin B98);

(b) korrigjimi i një shkeljeje në një marrëveshje afatgjatë huaje të klasifikuar si afatshkurtër (shih paragrafin B102);

(c) marrja nga huadhënësi e një periudhe faljeje për të korrigjuar një shkelje të një marrëveshjeje afatgjatë huaje të klasifikuar si afatshkurtër (shih paragrafin B103); dhe

(d) shlyerja e një detyrimi të klasifikuar si afatgjatë (shih paragrafin B104).

B106 Kur zbaton paragrafët 101–102 dhe B96–B103, njësia ekonomike mund të klasifikojë detyrimet që vijnë nga marrëveshjet e huasë si afatgjata nëse e drejta e njësisë ekonomike për të shtyrë shlyerjen e këtyre detyrimeve është subjekt i plotësimit të premtimeve kufizuese nga njësia ekonomike brenda 12 muajve nga periudha e raportimit (shih paragrafin B100(b)). Në rrethana të tilla njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues në shënimet, për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë rrezikun se detyrimet mund të bëhen për t'u paguar brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit, duke përfshirë:

(a) informacion mbi premtimet kufizuese (përfshirë natyrën e premtimeve kufizuese dhe se kur njësia ekonomike duhet t'i plotësojë ato) dhe vlerën kontabël (neto) të detyrimeve përkatëse.

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) fakte dhe rrethana, nëse ka, që tregojnë se njësia ekonomike mund të ketë vështirësi në plotësimin e premtimeve kufizuese—për shembull, njësia ekonomike ka vepruar gjatë ose pas periudhës së raportimit për të shmangur apo zbutur një shkelje të mundshme. Gjithashtu, të tilla fakte dhe rrethana mund të përfshijnë faktin që njësia ekonomike nuk do të kishte plotësuar premtimet kufizuese nëse ato do të ishin vlerësuar mbi pajtueshmërinë bazuar në rrethanat e njësisë ekonomike në fund të periudhës së raportimit.

Shlyerja (paragrafët 101(a), 101(c) dhe 101(d))

B107 Me qëllim klasifikimin e një detyrimi si afatshkurtër ose afatgjatë, shlyerja i referohet një transferimi tek pala tjetër që sjell eleminimin e detyrimit. Transferimi mund të jetë:

(a) në mjete monetare ose në burime të tjera ekonomike—për shembull, mallra ose shërbime; ose

(b) në instrumente të kapitalit të vet të njësisë ekonomike, me përjashtim të rastit kur zbatohet paragrafi B108.

B108 Kushtet e një detyrimi që, sipas mundësisë së palës tjetër, sjellin shlyerjen e tij duke transferuar instrumente të kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk e ndikojnë klasifikimin e tij si afatshkurtër apo afatgjatë nëse njësia ekonomike e klasifikon mundësinë si një instrument kapitali neto, duke e njohur veçmas nga detyrimi si një përbërës kapitali neto i një instrumenti financiar të përbërë, në zbatim të SNK 32.

Zërat për t'u paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar ose për t'u dhënë si informacion shpjegues në shënimet

B109 Paragrafët 24 dhe 41(c) kërkojnë që një njësi ekonomike të paraqesë nënzëra shtesë në pasqyrën e pozicionit financiar nëse kjo është e nevojshme për të dhënë një përmbledhje të strukturuar të dobishme të aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitalit neto të njësisë ekonomike. Njësia ekonomike përdor gjykimin për të bërë këtë përcaktim (përfshirë nëse është e nevojshme të ndajë nënzërat e renditur në paragrafin 103). Paragrafi 41 kërkon që njësia ekonomike të mbështesë gjykimet e saj në një vlerësim nëse zërat kanë karakteristika të përbashkëta (karakteristika të ngjashme) ose karakteristika jo të përbashkëta (karakteristika jo të ngjashme). Për nënzërat shtesë të aktiveve dhe detyrimeve, njësia ekonomike e mbështet gjykimin e saj në një vlerësim mbi natyrën ose funksionin e aktiveve apo detyrimeve. Karakteristikat e renditura në paragrafët B110(c)–(k) mund të ndihmojnë njësinë ekonomike në identifikimin e natyrës ose funksionit të aktiveve dhe detyrimeve.

B110 Paragrafët 20 dhe 41(d) kërkojnë që njësia ekonomike të ndajë zërat për të dhënë informacion shpjegues material në shënimet. Për të realizuar këtë, një njësi ekonomike përdor gjykimin e saj mbështetur në një vlerësim nëse zërat kanë karakteristika të përbashkëta (karakteristika të ngjashme) ose karakteristika jo të përbashkëta (karakteristika jo të ngjashme). Karakteristika të tilla përfshijnë:

(a) natyrën;

(b) funksionin (rolin) brenda aktiviteteve të biznesit të njësisë ekonomike;

(c) kohëzgjatjen dhe momentin e rikuperimit ose shlyerjes (duke përfshirë nëse aktivi ose detyrimi klasifikohet si afatshkurtër ose afatgjatë apo nëse rikuperimi apo shlyerja e tij janë pjesë e ciklit të shfrytëzimit të njësisë ekonomike);

(d) likuiditetin;

(e) bazat e matjes;

(f) matjen e pasigurisë ose rezultatin e pasigurisë (ose rreziqe të tjera të lidhura me një zë);

(g) madhësinë;

(h) zonën gjeografike ose mjedisin rregullator;

(i) llojin, për shembull, lloji i mallit, shërbimit apo klientit;

(j) efektet tatimore—për shembull, nëse aktivet ose detyrimet kanë baza tatimore të ndryshme; dhe

(k) kufizimet në përdorim të një aktivi ose në mundësinë e transferimit të një detyrimi.

B111 Aktive, detyrime dhe zëra të kapitalit neto që mund të kenë karakteristika të ndryshme të mjaftueshme, për të cilët paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar është e nevojshme për të siguruar një përmbledhje të strukturuar të dobishme ose dhënia e informacionit shpjegues në shënime është e nevojshme për të dhënë informacion material, përfshijnë:

(a) aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të ndarë në klasa në përputhje me SNK 16;

(b) llogaritë e arkëtueshme të ndara në shuma për t'u arkëtuar nga klientët tregtarë, të arkëtueshme nga palët e lidhura, parapagime dhe shuma të tjera;

(c) inventarët të ndarë në zbatim të SNK 2, në klasifikime të tilla si mallra, furnizime për prodhim, materiale, prodhim në proces dhe produkte të përfunduara;

(d) të pagueshme tregtare të ndara në zbatim të SNK 7, për të dhënë veçmas shumat e të pagueshme që janë pjesë e marrëveshjeve financiare të furnizimit;

(e) provizionet e ndara në përputhje me natyrën e tyre, të tilla si provizionet për përfitimet e punonjësve, detyrimet për nxjerrje nga përdorimi ose zëra të tjerë; dhe

(f) kapitali neto i kontribuar dhe rezervat të ndarë në disa klasa si kapitali i paguar, prime të lidhur me aksionin dhe rezervat.

Shënimet

Struktura

B112 Paragrafi 114 kërkon që njësia ekonomike të paraqesë shënimet në mënyrë sistematike për sa është praktikisht e mundur të realizohet. Shembuj të renditjes apo grupimit sistematik të shënimeve përfshijnë:

(a) vënia në dukje e pjesëve të aktivitetit të njësisë ekonomike të cilat ajo i konsideron si më të rëndësishme për të kuptuar pozicionin financiar dhe performancën financiare të saj, të tilla si grupimi bashkë i informacionit rreth aktiviteteve të caktuara të biznesit;

(b) grupimi bashkë i informacionit rreth zërave të matur në mënyrë të ngjashme të tilla si aktivet e matura me vlerën e drejtë; ose

(c) ndjekja e një rendi për nënzërat në pasqyrën(at) e fitimit ose humbjes dhe në pasqyrën e pozicionit financiar, të tillë si:

(i) deklarata e pajtueshmërisë me Standardet e Kontabilitetit SNRF (shih paragrafin 6B të SNK 8);

(ii) informacioni material mbi politikat kontabël (shih paragrafin 27A të SNK 8);

(iii) informacioni mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën(at) e performancës financiare, në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto si dhe pasqyrën e fluksit monetar, sipas radhës së paraqitjes së secilës pasqyrë dhe të secilit zë; dhe

(iv) informacione shpjeguese të tjera të cilat përfshijnë:

(1) detyrimet e kushtëzuara (shih SNK 37) dhe angazhimet kontraktuale të panjohura; dhe

(2) informacionet shpjeguese jofinanciare—për shembull objektivat dhe politikat e njësisë ekonomike mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shih SNRF 7).

Matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi

Identifikimi i matësve të performancës të përcaktuar nga drejtimi

B113 Paragrafi 117 përkufizon matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi. Një njësi ekonomike mund të mos ketë asnjë matës performance të përcaktuar nga drejtimi, mund të ketë një matës ose më shumë se një matës performance të përcaktuar nga drejtimi. Për shembull, një njësi ekonomike që komunikon publikisht performancën e saj financiare tek përdoruesit e pasqyrave financiare duke përdorur vetëm totalet dhe nëntotalet e kërkuara për paraqitje ose dhënie informacionesh shpjeguese nga Standardet e Kontabilitetit SNRF, nuk ka matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi.

B114 Për të plotësuar përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi, matësi duhet të komunikojë tek përdoruesit e pasqyrave financiare këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi. Për shembull, nëse një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhet me një segment raportues të shpjeguar në shënime në përputhje me SNRF 8 nuk jep

 © Fondacioni i SNRF-ve

informacion mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi, ky nëntotal nuk plotëson përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi.

B115 Megjithatë, ndonjëherë një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhet me një segment raportues mund të japë informacion mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi. Për shembull, nëse segmenti raportues përmban një aktivitet kryesor biznesi të vetëm të njësisë ekonomike dhe një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhet me atë segment paraqitet në pasqyrën e fitimit ose humbjes, kjo mund të tregojë së nëntotali siguron informacion rreth një aspekti të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi. Në raste të tilla, një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që lidhet me atë segment raportues do të plotësojë përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi nëse ai plotëson pjesët e tjera të përkufizimit të matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi.

Nëntotalet e të ardhurave dhe të shpenzimeve

B116 Një matës performance i përcaktuar nga drejtimi është një nëntotal i të ardhurave dhe i shpenzimeve. Shembuj të matësave që nuk janë matësa performance të përcaktuar nga drejtimi, sepse nuk janë nëntotale të të ardhurave dhe të shpenzimeve, përfshijnë:

(a) nëntotalet vetëm të të ardhurave ose vetëm të shpenzimeve (për shembull, një matës i vetëm i të ardhurave të rregulluara që nuk është pjesë e një nëntotali dhe që përfshin edhe shpenzimet);

(b) aktivet, detyrimet, kapitali neto ose kombinimin e këtyre elementëve;

(c) raportet financiare (për shembull, kthimi mbi aktivet) (shih paragrafin B117);

(d) matësit e likuiditetit ose të flukseve të mjeteve monetare (për shembull, flukset e lira të mjeteve monetare); ose

(e) matësit jofinanciar të performancës.

B117 Një raport financiar nuk është një matës performance i përcaktuar nga drejtimi, sepse nuk është një nëntotal i të ardhurave dhe i shpenzimeve. Megjithatë, një nëntotal që është numërues ose emërues në një raport financiar është matës performance i përcaktuar nga drejtimi, nëse nëntotali do të plotësojë përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi nëse do të ishte pjesë e raportit. Për pasojë, një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 121–125, për numërues apo emërues të tillë.

B118 Një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve që plotëson përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi në paragrafin 117 është një matës performance i përcaktuar nga drejtimi pavarësisht nëse paraqitet ose jo në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Komunikimet publike

B119 Një nëntotal plotëson përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi vetëm nëse njësia ekonomike e përdor atë në komunikimet jashtë pasqyrave financiare të saj. Komunikimet publike përfshijnë raportin e drejtimit, deklaratat për shtyp dhe prezantimet për investitorët. Me qëllim përkufizimin e matësave të performancës të përcaktuar nga drejtimi, komunikimet publike nuk përfshijnë komunikimet me gojë, transkriptet e komunikimeve me gojë dhe publikimet në rrjetet sociale.

B120 Matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi lidhen me të njëjtën periudhë raportuese si dhe pasqyrat financiare. Konkretisht, një nëntotal:

(a) që lidhet me pasqyrat financiare të ndërmjetme, por jo me pasqyrat financiare vjetore, mund të jetë vetëm një matës performance i përcaktuar nga drejtimi në pasqyrat financiare të ndërmjetme; dhe

(b) që lidhet me pasqyrat financiare vjetore, por jo me pasqyrat financiare të ndërmjetme, mund të jetë vetëm një matës performance i përcaktuar nga drejtimi në pasqyrat financiare vjetore.

B121 Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë vetëm komunikimet publike që lidhen me periudhën raportuese për të identifikuar matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi për periudhën raportuese, me përjashtim të rastit kur si pjesë e raportimit të saj financiar ajo nxjerr në mënyrë të rregullt komunikime publike pas datës së publikimit të pasqyrave financiare të saj. Në këtë rast, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë komunikimet publike të lidhura me periudhën raportuese të mëparshme për të identifikuar matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi për periudhën raportuese aktuale.

B122 Megjithatë, një matës i përdorur në komunikimet publike që lidhen me periudhën raportuese të mëparshme nuk është e nevojshme të identifikohet si matës performance i përcaktuar nga drejtimi për periudhën raportuese aktuale, nëse ka evidencë që tregon se ai nuk do të përfshihet në komunikimet publike që do të nxirren lidhur me periudhën raportuese aktuale. Nëse një matës i tillë është dhënë në informacionet

shpjeguese si një matës performance i përcaktuar nga drejtimi në periudhën raportuese të mëparshme dhe nuk është identifikuar si i tillë në periudhën raportuese aktuale, ky do të ishte një ndryshim ose një ndërprerje e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi, për të cilin zbatohen kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafit 124.

Nëntotalet e ngjashme me fitimin bruto

B123 Në përputhje me paragrafin 118(a), nëntotalet e ngjashme me fitimin bruto nuk janë matës performance të përcaktuar nga drejtimi. Një nëntotal është i ngjashëm me fitimin bruto kur ai përshkruan diferencën mes një lloji të të ardhurave dhe shpenzimeve të lidhura drejtpërdrejt, të kryera për gjenerimin asaj të ardhure. Shembujt përfshijnë:

(a) të ardhurat neto nga interesi;

(b) të ardhurat neto nga komisionet dhe tarifat;

(c) rezultati nga shërbimi i sigurimit;

(d) rezultati financiar neto (të ardhurat nga investimi minus të ardhurat dhe shpenzimet financiare të sigurimit); dhe

(e) të ardhurat neto nga qiraja.

Supozimi mbi komunikimin e këndvështrimit të drejtimit

B124 Paragrafi 119 përcakton se një nëntotal i të ardhurave dhe shpenzimeve i përdorur në komunikimet publike jashtë pasqyrave të saj financiare supozon se u komunikon përdoruesve të pasqyrave financiare këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi. Kur zbaton paragrafin 120, njësia ekonomike lejohet që të kundërshtojë atë supozim nëse ka në dispozicion informacion të arsyeshëm dhe mbështetës që provon se:

(a) nëntotali nuk komunikon tek përdoruesit e pasqyrave financiare, këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi (shih paragrafët B125–B128); dhe

(b) njësia ekonomike ka një arsye tjetër për përdorimin e nëntotalit në komunikimet publike të saj, të ndryshme nga komunikimi i këndvështrimit të drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi (shih paragrafin B129).

B125 Shembuj të informacionit të arsyeshëm dhe mbështetës që provon se nëntotali nuk komunikon tek përdoruesit e pasqyrave financiare, këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi, janë:

(a) komunikimi i nëntotalit pa një dallim nga njësia ekonomike (shih paragrafin B126); dhe

(b) mospërdorimi i nëntotalit brenda njësisë ekonomike për të vlerësuar apo monitoruar performancën financiare (shih paragrafët B127–B128).

B126 Nëse njësia ekonomike komunikon një nëntotal pa dallim është çështje gjykimi që mbështetet në një numër faktorësh, për shembull:

(a) numri i referencave ndaj nëntotalit—pak referenca tregon një mungesë rëndësie, shumë referenca tregon rëndësi; dhe

(b) përmbajtja e raportit ose analiza mbi apo të bazuara në nëntotal, për shembull:

(i) një përshkrim i nëntotalit si informacion që nuk komunikon këndvështrimin e drejtimit dhe që jepet vetëm si përgjigje ndaj kërkesave të shpeshta nga disa përdorues të pasqyrave financiare tregon një mungesë rëndësie;

(ii) përdorimi i nëntotalit për të mbështetur analizën dhe raportin e drejtimit mbi performancën financiare të njësisë ekonomike, si dhe për të shpjeguar arsyet e ndryshimit në nëntotal nga periudha në periudhë tregon rëndësi; dhe

(iii) një krahasim i nëntotalit me atë të konkurrentëve ose nëntotalet standard të industrisë tregon rëndësi.

B127 Përdorimi nga drejtimi i një nëntotali për të vlerësuar ose monitoruar një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi tregon se ai nëntotal komunikon këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi. Megjithatë, nëse drejtimi e përdor një nëntotal brenda njësisë ekonomike, por jo në komunikimet publike për njësinë ekonomike, nëntotali nuk plotëson përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi.

 © Fondacioni i SNRF-ve

B128 Njësia ekonomike mund të rregullojë një nëntotal të komunikuar në komunikimet publike për përdorim të brendshëm nga drejtimi për të vlerësuar ose monitoruar performancën financiare të njësisë ekonomike. Në raste të tilla, njësia ekonomike do të përdorë gjykimin e saj për të vlerësuar nëse nëntotali për përdorim të brendshëm është i ngjashëm mjaftueshëm me nëntotalin që përdor në komunikimet publike dhe të zbatojë paragrafin B127. Sa më të ngjashëm të jenë nëntotalet, aq më shumë mundësi ka që nëntotali i përdorur në komunikimet publike të njësisë ekonomike të komunikojë tek përdoruesit e pasqyrave financiare këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi.

B129 Shembuj të informacionit të arsyeshëm dhe mbështetës që provon se njësia ekonomike ka një arsye tjetër për përdorimin e një nëntotali në komunikimet publike, të ndryshëm nga komunikimi tek përdoruesit e pasqyrave financiare të saj të këndvështrimit të drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi, janë:

(a) nëntotali kërkohet në komunikimin publik nga ligji apo rregullatori;

(b) nëntotali komunikon performancën lidhur me pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me një kuadër kontabël të ndryshëm nga Standardet e Kontabilitetit SNRF;

(c) nëntotali përdoret në një komunikim publik për të plotësuar kërkesën e një pale të jashtme; ose

(d) nëntotali përdoret në komunikimin publik me qëllim komunikimin e informacionit të ndryshëm nga performanca financiare.

B130 Paragrafi 120 zbatohet për një nëntotal dhe jo për një zë individual të të ardhurave dhe shpenzimeve që përfshin nëntotali. Për pasojë, njësia ekonomike nuk mund të pohojë që nëntotali nuk komunikon këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi, bazuar në informacionin që tregon se zëri individual (zërat) i të ardhurave ose shpenzimeve brenda nëntotalit nuk paraqet këtë këndvështrim.

B131 Njësia ekonomike mund të ndryshojë përdorimin e një nëntotali për të komunikuar tek përdoruesit e pasqyrave financiare këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi. Si rezultat, një nëntotal mund të bëhet ose të përfundojë së qëni një matës performance i përcaktuar nga drejtimi. Për të identifikuar nëse një matës jo i identifikuar më parë si një matës performance i përcaktuar nga drejtimi është bërë i tillë, apo nëse një matës i identifikuar më parë si një matës performance i përcaktuar nga drejtimi ka përfunduar së qëni i tillë, kërkohet gjykim. Për shembull, një njësie ekonomike mund t'i kërkohet nga një rregullator të raportojë një nëntotal të caktuar, i cili kur është përdorur fillimisht nuk komunikonte këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi. Me kalimin e kohës, procesi i raportimit të totalit mund të sjellë që drejtimi ta përdorë matësin brenda njësisë ekonomike për të vlerësuar dhe monitoruar performancën financiare të saj ose të zgjerojë raportin dhe shpjegimet në komunikimet publike përtej kërkesave rregullatore, me rezultatin që matësi të plotësojë përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi.

Dhënia e informacioneve shpjeguese mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi

Shënimi i vetëm për informacionin mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi

B132 Paragrafi 122 kërkon që njësia ekonomike duhet të përfshijë në një shënim të vetëm të gjithë informacionin mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi të kërkuar nga paragrafët 121–125. Nëse njësia ekonomike jep informacion shpjegues edhe mbi informacione të tjera në atë shënim, informacioni në shënim duhet të emërtohet në mënyrë që dallon qartë informacionin e kërkuar nga paragrafët 121–125 nga informacioni tjetër.

B133 Për shembull, nëse njësia ekonomike zbaton SNRF 8 dhe informacioni mbi segmentin raportues përfshin një matës performance të përcaktuar nga drejtimi, ajo mund të japë informacionin shpjegues të kërkuar mbi matësin e performancës të përcaktuar nga drejtimi, në të njëjtin shënim si dhe informacionin tjetër të segmentit raportues, me kushtin që njësia ekonomike ose të:

(a) përfshijë në atë shënim informacionin e kërkuar nga paragrafët 121–125 për të gjithë matësit e saj të performancës të përcaktuar nga drejtimi dhe të emërtojë, në plotësim të kërkesave në paragrafin B132, informacionin në shënim në një mënyrë që dallon qartë informacionin e kërkuar nga paragrafët 121–125 nga informacioni i kërkuar nga SNRF 8; ose

(b) të sigurojë një shënim të veçantë që përfshin informacionin e kërkuar për të gjithë matësit e saj të performancës të përcaktuar nga drejtimi, përfshirë ata për të cilët njësia ekonomike përfshin informacion në informacionin për segmentin raportues.

Një mënyrë e qartë dhe e kuptueshme

B134 Paragrafi 123 kërkon që njësia ekonomike të emërtojë dhe përshkruajë matësit e saj të performancës të përcaktuar nga drejtimi në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, që nuk çorienton përdoruesit e pasqyrave financiare. Për të siguruar një përshkrim të tillë, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues që i mundëson një përdoruesi të pasqyrave financiare të kuptojë zërat e të ardhurave ose shpenzimeve të përfshira dhe të përjashtuara nga nëntotali. Prandaj, njësia ekonomike duhet të:

(a) emërtojë dhe përshkruajë matësin në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e tij në përputhje me paragrafin 43 (shih paragrafin B135); dhe

(b) sigurojë informacion specifik për matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi—që do të thotë:

(i) nëse njësia ekonomike ka llogaritur matësin në një mënyrë tjetër, të ndryshme nga përdorimi i politikave kontabël të përdorura për zërat në pasqyrën(at) e performancës financiare, ajo duhet ta deklarojë këtë fakt dhe të paraqesë llogaritjet e bëra për matësin; dhe

(ii) për më tepër, nëse llogaritja e matësit ndryshon nga politikat kontabël të kërkuara apo të lejuara nga Standardet e Kontabilitetit SNRF, njësia ekonomike duhet ta deklarojë këtë fakt shtesë dhe nëse është e nevojshme duhet të japë një shpjegim mbi kuptimin e termave që përdor (shih paragrafin B135(b)).

B135 Për të emërtuar dhe përshkruar matësin në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e tij, njësia ekonomike do të:

(a) emërtojë matësin në një mënyrë që paraqet karakteristikat e nëntotalit (për shembull duke përdorur emërtimin 'fitimi i shfrytëzimit para shpenzimeve jo-të shpeshta' vetëm për një nëntotal që përjashton nga fitimi i shfrytëzimit të gjitha shpenzimet e identifikuara nga njësia ekonomike si jo të shpeshta); dhe

(b) shpjegojë kuptimin e termave që përdor në përshkrimet e saj që janë të nevojshme për të kuptuar aspektin e performancës financiare që po komunikohet (për shembull, të shpjegojë sesi njësia ekonomike përkufizon 'shpenzimet jo të shpeshta').

Rakordimi me totalin ose nëntotalin më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti

B136 Paragrafi 123(c) kërkon që një njësi ekonomike të rakordojë secilin matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi me nëntotalin më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti, të renditur në paragrafin 118 ose totalin apo nëntotalin e kërkuar në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF. Për shembull, njësia ekonomike, që jep informacion shpjegues në shënime për një matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi mbi fitimin ose humbjen e aktivitetit të shfrytëzimit të rregulluar, duhet të rakordojë këtë matës me fitimin ose humbjen e aktivitetit të shfrytëzimit. Në grupimin ose ndarjen e zërave të dhënë në informacionin shpjegues, njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat në paragrafët 41–43.

B137 Për çdo zë të rakorduar, njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues:

(a) shumën(at) e lidhur me secilin nënzë në pasqyrën(at) e performancës financiare; dhe

(b) një përshkrim sesi është llogaritur zëri dhe sesi ai kontribuon në matësin e performancës të përcaktuar nga drejtimi, duke siguruar informacion të dobishëm (shih paragrafët B138–B140), nëse është e nevojshme për të siguruar informacionin e kërkuar nga paragrafët 123(a) dhe 123(b).

B138 Përshkrimi i kërkuar në paragrafin B137(b) kërkohet nëse ka më shumë se një zë të rakorduar dhe secili zë është llogaritur duke përdorur një metodë të ndryshme apo kontribuon në sigurimin e informacionit të dobishëm në një mënyrë të ndryshme. Për shembull, njësia ekonomike mund të përjashtojë nga një matës performance të përcaktuar nga drejtimi zëra të ndryshëm shpenzimesh, disa sepse ishin identifikuar si jashtë kontrollit të drejtimit dhe të tjerë, sepse ishin identifikuar si jo të përsëritura. Në raste të tilla, dhënia e informacioneve shpjeguese se cili zë ka kontribuar për secilin tip rregullimi, do të kërkohej për të shpjeguar sesi matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi siguron informacion të dobishëm.

B139 Një shpjegim i vetëm mund të zbatohet për një ose më shumë zëra ose mund të zbatohet për të gjitha rakordimet së bashku. Për shembull, njësia ekonomike mund të përjashtojë disa zëra të të ardhurave ose shpenzimeve në llogaritjen e një matësi të performancës të përcaktuar nga drejtimi bazuar në zbatimin specifik të njësisë ekonomike të 'jo të përsëritura'. Në një rast të tillë, një shpjegim i vetëm që përfshin përkufizimin e njësisë ekonomike për 'jo të shpeshta', që zbatohet për të gjithë zërat e rakorduar, mund të plotësojë kërkesat në paragrafin B137(b).

 © Fondacioni i SNRF-ve

B140 Kur zbaton paragrafin 123(c), njësisë ekonomike i lejohet që të rakordojë një matës performance të përcaktuar nga drejtimi me një total ose nëntotal që nuk është paraqitur në pasqyrën(at) e performancës financiare. Në raste të tilla, njësia ekonomike:

(a) do të rakordojë atë total ose nëntotal me totalin ose nëntotalin më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti të paraqitur në pasqyrën(at) e performancës financiare; dhe

(b) nuk kërkohet që të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 123(d) dhe 123(e) për rakordimin në (a).

Efekti në tatimin mbi të ardhurat për secilin zë të dhënë në informacionet shpjeguese të rakordimit

B141 Një njësie ekonomike i kërkohet nga paragrafi 123(d) që të japë informacion shpjegues mbi efektin në tatimin mbi të ardhurat për secilin zë të shpjeguar në rakordimin mes një matësi të performancës të përcaktuar nga drejtimi dhe nëntotalit më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti, të renditur në paragrafin 118 ose totalit apo nëntotalit të kërkuar në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF. Njësia ekonomike duhet të përcaktojë efektin në tatimin mbi të ardhurat, të kërkuar nga paragrafi 123(d), duke llogaritur efektet në tatimin mbi të ardhurat të transaksionit(eve)bazë:

(a) me normën(at) tatimore statutore të zbatueshme për transaksionin(et) në juridiksionin(et) tatimor që i përket;

(b) bazuar në një shpërndarje të arsyeshme pro rata të tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë të njësisë ekonomike në juridiksionin(et) tatimor që i përket; ose

(c) duke përdorur një metodë tjetër që, nisur nga rrethanat, jep një shpërndarje më të përshtatshme.

B142 Nëse, kur zbaton paragrafin B141, njësia ekonomike përdor më shumë se një metodë për llogaritjen e efekteve në tatimin mbi të ardhurat të zërave të rakorduar, ajo duhet të japë informacion shpjegues sesi ka përcaktuar efektet tatimore për secilin zë të rakorduar.

Shtojca C
Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit të Kontabilitetit SNRF.

Data e hyrjes në fuqi

C1 Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më 1 janar 2027 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt në shënime.

Periudha kalimtare

C2 Njësia ekonomike do të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive duke zbatuar SNK 8. Megjithatë, njësisë ekonomike nuk i kërkohet të paraqesë informacionin sasior të cilësuar në paragrafin 28(f) të SNK 8. Njësisë ekonomike që zbaton SNRF 19 *Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese* nuk i kërkohet të paraqesë informacionin sasior të kërkuar në paragrafin 178(f) të SNRF 19.

C3 Në pasqyrat e saj financiare vjetore njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese për periudhën krahasuese që paraprin menjëherë periudhën në të cilën ky Standard zbatohet për herë të parë, një rakordim për secilin nënzë në pasqyrën e fitimit ose humbjes mes:

(a) shumave të riparaqitura duke zbatuar këtë Standard; dhe

(b) shumave të paraqitura më parë duke zbatuar SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*.

C4 Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 34, kur përgatit pasqyra financiare të ndërmjetme të përmbledhura në vitin e parë të zbatimit të këtij Standardi, njësia ekonomike duhet të paraqesë në pasqyra financiare të ndërmjetme të përmbledhura çdo titull që pret të përdorë në zbatim të këtij Standardi, si dhe nëntotalet e kërkuara nga paragrafët 69–74 të këtij Standardi, pavarësisht kërkesave në paragrafin 10 të SNK 34. Njësia ekonomike nuk do të zbatojë kërkesat në paragrafin 10 të SNK 34 për tituj dhe nëntotale në pasqyra financiare të ndërmjetme të përmbledhura deri sa të ketë publikuar paketën e parë të pasqyrave financiare vjetore të përgatitura në përputhje me këtë Standard.

C5 Nëse njësia ekonomike zbaton SNK 34 për përgatitjen e pasqyrave financiare të ndërmjetme në vitin e parë të zbatimit të këtij Standardi, njësia ekonomike, si pjesë të informacionit të kërkuar nga paragrafi 16A(a) i SNK 34, do të japë informacion shpjegues mbi rakordimet për secilin nënzë të paraqitur në pasqyrën e fitimit ose humbjes për periudhat krahasuese që menjëherë paraprijnë aktualen dhe periudhat aktuale të akumuluara. Rakordimet kërkohen mes:

(a) shumave të riparaqitura duke zbatuar politikat kontabël për periudhën krahasuese dhe periudhën krahasuese të akumuluar kur njësia ekonomike zbaton këtë Standard; dhe

(b) shumave të paraqitura më parë duke zbatuar politikat kontabël për periudhën krahasuese dhe periudhën krahasuese të akumuluar kur njësia ekonomike zbatonte SNK 1.

Një njësi ekonomike që zbaton SNRF 19 *Filiale pa Përgjegjësi Publike*: Do të jap *informacion shpjegues* në vend që të zbatoj kërkesat për dhënie të informacionit shpjegues në paragrafin 246(a) të SNRF 19.

C6 Një njësi ekonomike lejohet, por nuk kërkohet të japë informacionin shpjegues të përshkruar në paragrafët C3 dhe C5 për periudhën aktuale ose periudhat krahasuese më të hershme.

C7 Në datën e zbatimit për herë të parë të këtij Standardi, një njësi ekonomike që ka të drejtë të zbatojë paragrafin 18 të SNK 28, lejohet të ndryshojë zgjedhjen e saj për matjen e një investimi në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët nga metoda e kapitalit neto tek metoda e vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Nëse njësia ekonomike bën një ndryshim të tillë, ajo duhet të zbatojë ndryshimin në mënyrë retrospektive duke zbatuar SNK 8. Kur zbaton paragrafin 11 të SNK 27, njësia ekonomike duhet të bëjë të njëjtin ndryshim në pasqyrat financiare individuale të saj.

Tërheqja e SNK 1

C8 Ky Standard zëvendëson SNK 1.

 © Fondacioni i SNRF-ve